



STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

NDIKIMI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NË ZVOGËLIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE

MENTOR:

KANDIDATI:
Pajtesa Hajrullahu

Tetovë, 2022

Përmbajtja

FALENDERIM	3
ABSTRAKTI.....	5
QËLLIMET E HULUMTIMIT	7
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	7
HIPOTEZAT	8
KAPITULLI 1	Error! Bookmark not defined.
1. PJESA TEORIKE	9
1.1 Puna e fëmijëve.....	9
1.2 Trafikimi i fëmijëve jashtë vendit për qëllime punësimi.....	9
1.3 Korniza ligjore mbi punën e fëmijëve	11
1.4 Sistemi i monitorimit të punës së fëmijëve (SMPF).....	12
1.5Kategoritë dhe fazat e punës së fëmijëve.....	13
1.6 Shkaqet e punës së fëmijëve	14
1.7 Strategjia e Republikës së Kosovës për eliminimin e punës së fëmijëve.....	17
1.8 Dimensionet institucionale për parandalimin e punës së fëmijëve	18
1.9 Konventat e ILO-s për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve	21
KAPITULLI 2	25
2. POLITIKAT SOCIALE NË KOSOVË.....	26
2.1 Punësimi dhe mirëqenia në Kosovë.....	26
2.2 Tregu i punës në Kosovë	27
2.3 Të rinjtë dhe problemet e tyre në Republikën e Kosovës.....	29
2.4 Edukimi joformal i të rinjëve dhe adoleshentëve	30
2.5 Situata ekonomike dhe problemet sociale në Kosovë.....	33
2.6 Kategoritë sociale të cilat ndihmohen përmes skemave sociale të qeverisë së Kosovës.....	35
2.7 Programi i ndihmës sociale të Kosovës.....	36
2.8 Strategjia e punësimit e Republikës së Kosovës	37
2.9 Shërbimi publik i punësimit në Kosovë	39
KAPITULLI 3	Error! Bookmark not defined.
3. PJESA EMPIRIKE.....	41
3.1 Aspekti empirik i punës së fëmijëve	42
3.2 Mostra e hulumtimit.....	43

3.3 Paraqitja dhe interpretimi i rezultateve statistikore	44
3.4 Vërtetimi i hipotezave.....	56
PËRFUNDIMI	58
LITERATURË E SHFRYTËZUAR	60

FALENDERIM

ABSTRAKTI

Në këtë punim të nivelit master, do të analizohet ndikimi i Organizatave Joqeveritare në zvogëlimin e punës së fëmijëve. Organizatat joqeveritare kanë ndikim të rëndësishëm në zvogëlimin e punës së fëmijëve. Aktivitetet e tyre të kordinuara mire ndikojnë shumë si te fëmijët ashtu edhe te prindërit e tyre që të reduktohet puna e tyre. Puna e fëmijëve është fenomen jo i mirë me të cilin po përballen të gjitha vendet e globit. Për shkak të strukturës dhe bazës së dobët ekonomike, problemeve sociale, sistemit të pazhvilluar juridik, sistemit jo të avancuar të edukimit, ende nuk po arrihet të zvogëlohet dhe të eliminohet në tërësi punën e fëmijëve. Prandaj organizatat joqeveritare kanë ndikim shumë më të madh sesa strukturat tjera në zvogëlimin e punës së fëmijëve, sepse përmes aktiviteteve që ndërmerren fëmijët vetëdijësohen që mos të punojnë në moshë shumë të re, dhe të mos keqpërdoren nga shumë organizata e grupe kriminale. Këto grupe kriminale i trafikojnë, i detyrojnë të kërkojnë lëmoshe madje edhe i torturojnë fëmijët e moshës delikate, për të realizuar dhe arritur objektivat e tyre kriminale e djallëzore.

Institucionet shtetërore siç janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Enti social përmes zyrtarëve të tyre mundohen që këta fëmijë t'i largojnë nga puna ngase mosha dhe zhvillimi psiko-social nuk ua lejon të punësohen qoftë me dëshirë qoftë me padëshirë. Përveç këtyre institucioneve, edhe organizatat joqeveritare zhvillojnë aktivitetet të ndryshme për të ndikuar në uljen e punës së fëmijëve. Organizatat joqeveritare vendore dhe të huaja të cilat veprojnë në Kosovë vazhdimisht zhvillojnë veprimtari interaktive dhe sensibilizuese që ndikojnë në uljen e numrit të fëmijëve punonjës.

OJQ-të kanë rol të rëndësishëm në vetëdijësimin e fëmijëve dhe të miturëve për të mos punuar dhe për të vijuar shkollimin dhe procesin e socializimit e emancipimit të tyre shoqëror. Kështuqë përmes evidencave empirike dhe literaturës teorike do të elaborohet kjo temë duke ofruar përfundime dhe rekomandime se çka duhet të bëhet nga OJQ-të për të zvogëluar punën e fëmijëve në shoqëritë e vendeve të pazhvilluara dhe atyre në zhvillim.

Fjalët kyçe: Organizatat joqeveritare (OJQ-të), fëmijët, puna, ndikimi, zvogëlimi.

ABSTRACT

In this master's thesis, the impact of NGOs on reducing child labor will be analyzed. Non-governmental organizations have a significant impact on reducing child labor. Their well-coordinated activities greatly influence both children and their parents to reduce their workload. Child labor is a bad phenomenon that all countries of the globe are facing. Due to the weak economic structure and base, social problems, underdeveloped legal system, underdeveloped education system, it is still not possible to reduce and eliminate child labor altogether. Therefore, non-governmental organizations have a much greater impact than other structures in reducing child labor, because through the activities undertaken children are made aware not to work at a very young age, and not to be abused by many criminal organizations and groups. These criminal groups traffic them, force them to ask for alms and even torture children of delicate age, in order to achieve and achieve their criminal and devilish goals.

State institutions such as the Ministry of Labor and Social Welfare, the Social Entity through their officials try to remove these children from work because age and psycho-social development do not allow them to be employed either willingly or unwillingly. In addition to these institutions, non-governmental organizations also carry out various activities to influence the reduction of child labor. Local and foreign non-governmental organizations operating in Kosovo continuously develop interactive and awareness-raising activities that reduce the number of working children.

NGOs have an important role to play in raising the awareness of children and juveniles not to work and to continue their education and the process of socialization and social emancipation. Thus, through empirical evidence and theoretical literature, this topic will be elaborated by providing conclusions and recommendations on what should be done by NGOs to reduce child labor in the societies of underdeveloped and developing countries.

Keywords: Non-governmental organizations (NGOs), children, work, influence, downsizing.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimet e këtij hulumtimi janë:

- Analizë e literaturës që ka të bëjë me punën e fëmijëve;
- Analizë e ndikimit të OJQ-ve në jetën e fëmijëve;
- Analizë e ndikimit të OJQ-ve në zvogëlimin e punës së fëmijëve;
- Nxjerrja e konkluzioneve lidhur me këtë problematikë.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Kërkimi shkencor për këtë tezë siguron bazën për të gjitha politikat qeveritare në sistemin socio-ekonomik. Prandaj edhe në analizimin e ndikimit të OJQ-ve në punën e fëmijëve, kërkimi shkencor ka rëndësi në zgjedhjen e problemeve të ndryshme sociale. Po ashtu kërkimi është i rëndësishëm për hulumtuesit e shkencave sociale në studimin e marrdhenieve shoqërore dhe problemet e ndryshme sociale. Për filozofët dhe mendimtarët e ndryshëm, kërkimi shkencor nënkupton krijimin e njohurive të reja. Ndërkaq për studiuesit universitar ka të bëjë me krijimin e hulumtimit unik që i bënë ata të dallohen prej të tjerëve¹.

Çdo kërkim shkencor realizohet sipas një metodologjie të caktuar. Sikurse çdo punim shkencor që e ka metodologjinë e vetë, edhe ky punim i nivelit master e ka metodologjinë e caktuar. Të dhënat parësore dhe detysore janë përdorur në këtë hulumtim. Të dhënat sekondare paraqesin literaturën e përdorur në shtjellimin e termeve dhe elementeve esenciale të problematikës së analizuar. Kurse të dhënat primare përbëhen prej të dhënave të fituara nga anketimi i 20 fëmijëve punonjës. Pyetësi konsiston prej 10 pyetjeve. Përgjigjet e këtyre fëmijëve janë përpunuar në Programin Statistikor SPSS dhe rezultatet janë paraqitur veç e veç për secilën pyetje të parashtruar nga ana e autores së punimit. Po ashtu edhe Testi Chi Square është përdorur në vërtetimin e hipotezave të parashtruara.

¹ Fisnik Morina, Metodatat e Hulumtimit Kuantitativ. Universiteti “Haxhi Zeka”. Qasur në: <https://unhz.weebly.com/>

HIPOTEZAT

Ndikimi I Organizatave joqeveritare ne edukimine prinderve, perkujdesjen ndaj femijëve te rrugës, te pa prinde etj dukshme zvoglon punen e femijeve

Supozohet se ne Kosovë OJQ kane nje ndikim ne rritje ne trajtimin dhe kujdesin per femijët e rrugës

Si femijë të rrugës ojQ kanë identifikuar me përqindje më të madhe femijët e komunitetet RAE, fëmijlt me një prind, fëmijët nga familjet të varfera etk

Hipoteza e parë e këtij punimi të nivelit master mund të definohet kështu:

H0: Organizatat joqeveritare (OJQ-të) ndikojnë pozitivisht në jetën e këtyre fëmijëve që punojnë në sektorë të ndryshëm;

H1: Organizatat joqeveritare (OJQ-të) nuk ndikojnë pozitivisht në jetën e këtyre fëmijëve që punojnë në sektorë të ndryshëm;

Hipoteza e dytë e këtij punimi është paraqitur më poshtë:

H0: Angazhimi i OJQ-ve, ka ndikuar që këta fëmijë të ndërprejnë punën e tyre;

H1: Angazhimi i OJQ-ve, nuk ka ndikuar që këta fëmijë të ndërprejnë punën e tyre;

Hipoteza e tretë dhe e fundit e këtij punimi mund të formulohet si më poshtë:

H0: Mosha e fëmijëve që punojnë ndikon në aktivitetin e tyre punues, pra sa më në moshë të jenë fëmijët aq më e lartë do të jetë mundësia e tyre për të punuar;

H1: Mosha e fëmijëve që punojnë nuk ndikon në aktivitetin e tyre punues.

KAPITULLI 1

1. PJESA TEORIKE

1.1 Puna e fëmijëve

Puna e fëmijëve përveç që pengon zhvillimin socio-psikologjik të tyre, po ashtu pengon edhe mirëqenien dhe komoditetin e tyre në rrethin ku jetojnë. Kjo punë ua rëndoj jetën e tyre si dhe arsimimin e tyre. Arsimimi dhe edukimi i tyre ndikohet negativisht nga puna që bëjnë. Sipas statistikave relevante, në botë janë 318,000,000 fëmijë të cilët janë aktiv në veprimtari të ndryshme ekonomike. Kurse 218,000,000 fëmijë kryjnë punë të ndryshme apo janë të angazhuar si fëmijë në punë të ndryshme. Duhet theksuar se pjesa tjetër mirret me veprimtari të cilat janë të pranueshme sipas ligjeve në fuqi.

Punëdhënësit dhe organizatat e tyre janë palë të rëndësishme në përpjekjet për të eliminuar punën e fëmijëve. Nuk është vetëm kjo shprehje që përdoret nga ILO (Organizata botërore e punës) për të përshkruar punën e fëmijëve, por ka edhe shprehje tjera që përdoren në këtë aspekt. Konventa e ILO-së për moshën minimale të punës (C138) bën thirrje që mosha minimale e punës të caktohet jo më e ulët sesa fundi i shkollimit të detyrueshëm dhe në çdo rast jo nën moshën 15 vjeçare (ose 14 vjeçare në shtetet në zhvillim). Përkufizimi i punës së lehtë Sidoqoftë puna e lehtë mund të lejohet për fëmijët e moshës në mes 13 e 15 vjeçare (ose 12 e 14 vjeçare në shtetet në zhvillim). Konventa përkufizon punën e lehtë për fëmijët në këtë mënyrë:

- Ajo punë e cila nuk e dëmton as zhvillimin psiko-social e as mendor të fëmijëve,
- nuk paragjykon vijimin e tyre në shkollë, pjesëmarrjen e tyre në programet e orientimit profesional dhe trajnimit të miratuara nga autoriteti kompetent, ose nuk ndikon në kapacitetin e tyre për të përfutur nga mësimnxënia².

1.2 Trafikimi i fëmijëve jashtë vendit për qëllime punësimi

² International Labour Organization, Punëdhënësit dhe Puna e Fëmijëve. Qasur në: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_169136.pdf

Trafikimi i fëmijëve është veprimtari shumë e dëmshme për fëmijët e gjithë globit. Këto veprimtari ndryshe quhet “skllavërim i kohëve moderne”. Duke qenë se konceptet e punës së detyruar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe skllavërisë janë të lidhura ngushtë me nismat e ILO, është rënë dakord me të gjitha organizatat relevante për fushën që për qëllime statistikore, termi "skllavëri moderne" do të përdoret për të mbuluar të gjitha praktikatat e përmendura më lartë.

Organet kompetente i morën disa vendime, duke përfshirë këtu dhe trafikimin e personave apo praktikave të ngjashme skllavëruese, duke miratuar një Protokoll dhe një Rekomandim i cili do të plotësonte Konventat ekzistuese dhe do t'i kushtonte një rëndësi specifike masave që duhet të ndërmerren me qëllim eliminimin e çdo lloji forme të punës së detyruar. Kështuqë ILO u përkushtua shumë në kordinimin internacional në luftë kundër trafikimit të fëmijëve.

Fenomeni i punës së fëmijëve është i rrënjosur aq thellë në shoqërinë shqiptare në Shqipëri e Kosovë, sa tashmë Shqipëria është kthyer në një nga dhjetë vendet që furnizojnë Bashkimin Europian me numrin më të madh të personave të trafikuar. Shqipëria është pjesë e 10 vendeve me numrin më të lartë të trafikuesve në krah të Nigerisë, Kinës, Turqisë, Brazilit apo Algjerisë. Statistikat e vetme tek të cilat mund të referohemi janë ato të Organizatave Ndërkombëtare apo organizatave lokale në vendet e BE-së të cilat kanë në fokusin e tyre evidentimin apo rehabilitimin e rasteve të trafikuar.

Vendet në të cilat drejtohen më së shumti fëmijët e trafikuar (përfshirë këtu fëmijët të cilët shfrytëzohen për punë), janë Greqia, Italia, Belgjika dhe Mbretëria e Bashkuar. Në vitin 2007, Greqia është raportuar si destinacioni kryesor i viktimave të ardhura tranzit nëpërmjet Shqipërisë apo nga Shqipëria. Fluksi i lartë drejtë Greqisë sigurisht është i lidhur ngushtësisht me afërsinë territoriale dhe me numrin e lartë të emigrantëve shqiptarë të cilët banojnë atje duke krijuar grupe të organizuara kriminale. Pjesa më e madhe dërgohen në Greqi me qëllim shfrytëzimin seksual, por të shumta janë rastet në të cilat fëmijët shfrytëzohen për punë të detyruar apo lypje. Kategoria e cila më së shumti shfrytëzohet për punë janë fëmijët nën moshën 12 vjeç³.

³ Instituti SEDA & Save the children, Puna e fëmijëve, Tiranë, 2015. Qasur në: https://childhub.org/sq/system/tdf/library/attachments/child_labor_report_dec_2015.pdf?file=1&type=node&id=19344

1.3 Korniza ligjore mbi punën e fëmijëve

Edhe në Kosovë, puna e fëmijëve është mjaftë e theksuar. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmbanë nene e akte të cilat rregullojnë punën e fëmijëve dhe aktivitetin e tyre ekonomik.

Ligji i punës (Nr. 03/L –212) përcakton moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare si moshë minimale për punësim. Marrëdhënia e punës me një person ndërmjet moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeçare mund të vendoset për punë të lehta të cilat nuk paraqesin rrezik për shëndetin dhe zhvillimin e tij/saj.

Ligji Nr. 03/L-002 I përkufizon të gjitha veprat qofshin ato penale apo llojit tjetër që kanë të bëjnë me veprat lidhur me aktivitetin e fëmijëve. Udhëzimi Administrativ për Parandalimin dhe Ndalimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve (17/2008) përfshin sektorët e rrezikshëm dhe aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që të ndalohen si çështje me prioritet në Kosovë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) I ka marr disa veprime që kanë të bëjnë me këtë çështje:

- Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për zbatimin e Programit Ndërkombëtar të ILO-së për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC) nga ana e OKB-së;
- Në vitin 2005 është themeluar njësia për punën e fëmijëve në kuadër të ministrisë;
- Themelimi i Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve (KKPEPF);
- Ofrimi i mbështetjes institucionale dhe sigurimi i pjesëmarrjes aktive të institucioneve publike lokale dhe qendrore;
- Hartimi i Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve, për të përcaktuar synime me afat kohor dhe për të siguruar dëshmi të qarta për zotimin e autoriteteve publike sa i përket përgjegjësisë dhe ndarjes së buxhetit për realizimin e planit.

Dija për punën e fëmijëve bazohet në këto pika:

- Përmbledhjen mbi Monitorimin e Punës së Fëmijëve (e përkthyer dhe botuar në shqip dhe serbisht), 2005 dhe 2020.
- Udhëzuesin për Inspektorë të Punës mbi Monitorimin e Punës së Fëmijëve (e përkthyer dhe e botuar në shqip dhe serbisht)
- Doracakun për Gazetar të rinj mbi Punën e Fëmijëve (anglisht, shqip dhe serbisht)
- Përmbledhjen nga broshurat e ACTRAV “Sindikatat dhe Puna e Fëmijëve” (shqip dhe serbisht)
- Përmbledhjen nga broshurat e ACT/EMP “Punëdhënësit dhe Puna e Fëmijëve” (shqip dhe serbisht)
- Profilin e Sistemit të Sigurisë Sociale në Kosovë (përbrenda konotacionit të Rezolutës 1244 të KSKB), (anglisht, shqip dhe serbisht), 2010 dhe 2019.
- Raportin mbi analizën e legjislacionit dhe politikave (planeve të veprimit dhe strategjive) mbi punën e fëmijëve dhe punësimin e të rinjve në Kosovë (anglisht, shqip dhe serbisht)
- Broshurën: “Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: çfarë mund të bëjnë sindikatat?”
- Broshurën: “Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: çfarë mund të bëjnë punëdhënësit?”

1.4 Sistemi i monitorimit të punës së fëmijëve (SMPF)

Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve (SMPF) synon:

- Identifikimin e fëmijëve në punë dhe vlerësimin e rreziqeve të cilave u ekspozohen;
- Referimin e fëmijëve në punë në shërbime për rehabilitim dhe/ose ofrimin e masave të mbrojtjes nga rreziqet si qasje e përkohshme;

Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Kosovë ka kontribuar në përfshirjen e çështjeve të punës së fëmijëve në sistemet e qeverisjes duke institucionalizuar procesin e punës me fëmijë. Arritjet kryesore në themelimin e Sistemit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve (SMPF) në Kosovë përfshijnë me sa vijon:

- Korniza institucionale e MPF në nivel qendror, përfshirë Grupin Teknik Punues mbi Monitorimin që është e themeluar me vendimin të Komitetit Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve në mars të vitit 2007 dhe është rishikuar në vitin 2019;
- Një Grup Themelor i trajnerëve, përfshirë përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Drejtësisë, Sindikata e Bashkuar për Arsim dhe Shkencë dhe OJQ;
- Profili Kosovar i MPF është miratuar nga Komiteti për Parandalimin dhe Eliminimin e këtyre veprimeve të dëmshme;
- Korniza institucionale në nivel lokal duke përfshirë Komitetet Lokale të Veprimit mbi SMPF për të a/koordinuar aktivitetet e MPF, b/ rishikuar të dhënat e konsoliduara për punën e fëmijëve nga Qendrat për Punë Sociale, c/përgatitur planet vjetore të veprimit për adresimin e punës së fëmijëve në nivel komunal dhe d/ofruar rekomandime mbi veprimet e duhura.
- Instituti për Politika Sociale-MPMS ka realizuar takime të nivelit të lartë me Kryetarët e Asambleve Komunale të 25 komunave si asaj të Kamenicës, Vitisë, Kaçanikut, Shtimes, Suharekës, Lipjanit, Pejës, Malishevës, Klinës, Fushë Kosovës, Skenderajt, Vushtrrisë, Mamushës, Rahovecit, Junikut, Deçanit, Podujevës, Hanit të Elezit, Klllokotit, Istogut, Gjakovës, Ranillugut, Novobërdës dhe Graçanicës).⁴

1.5 Kategoritë dhe fazat e punës së fëmijëve

Dy kategoritë kryesore që mund të përmenden janë:

1. Fëmijët që punojnë në sektorin e ndërtimtarisë, në fabrikat e ndryshme, etj. Këta fëmijë janë kryesisht nga mosha 14-18 vjeç. Puna e fëmijëve në sektorin formal parimisht është e

⁴ Organizata Ndërkombëtare e Punës, HAPAT E ILO-IPEC PËR ELIMINIMIN E FORMAVE MË TË RËNDA TË PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË, (2011). Qasur në: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_168280.pdf si dhe të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës që i janë ofruar autores së punimit në Mars të vitit 2022.

kontrollueshme nga Inspektoriati i Përgjithshëm i Punës, mirëpo mund të ndodhë që fëmijët të manipulohen për arsye të ndryshme.

2. Fëmijët që punojnë si lypsarë, si pastrues e kështu me radhë. Pra kjo është kategoria e dytë e fëmijëve të punësuar.

Fazat e punës së fëmijëve janë:

- Fillimi i punës: Këtë moment fëmijët mund ta përjetojnë në formën e një ndryshimi domethënës të botës së tyre sociale. Për disa fëmijë ky proces mund të shfaqet në mënyrë më graduale. Në këtë fazë fokusi kryesor i fëmijës mund të përfshijë mënyrën si trajtohet nga punëdhënësit dhe reagimi i tij ndaj kësaj eksperience përfshin tregues të stresit në rritje ose të jetës stresuese.
- Jeta në punë: Fëmiju tashmë është mësuar të punojë, ka fituar shprehi të punës dhe i duket normale të punojë në aktivitetet që i ndërmerrë.
- Përfundimi i fëmijërisë: Fëmiju e ka ndërprerë punën dhe mund të ketë filluar një punë tjetër. Pra tashmë ai emocionalisht është më i fuqishëm dhe për atë puna është shumë veprim normal.

Kushtet në të cilat punojnë fëmijët, janë një pikë shumë e rëndësishme për t'u analizuar. Sektori joformal punëson fëmijë të cilët aktivitetin e tyre e kryejnë në kushte jashtëzakonisht të rënda dhe madje të papërballueshme. Këto kushte fëmijëve mund të iu kushtojnë me jetë.

Këta fëmijë punojnë me kohë të pacaktuar, sepse shpesh rrezikohen të bëhen viktimat të dhunës fizike, nëse nuk kanë siguruar një shumë të caktuar të ardhurash ditore. Sipas Inspektoriatit të të Punës “ndodh shpesh që punëdhënësit nuk zbatojnë kushtet e punës, të parashikuara në Kodin e Punës.”

1.6 Shkaqet e punës së fëmijëve

Gjatë dekadave të kaluara shkaqet e punës së fëmijëve anembanë globit kanë mbetur gatise të njejta. Si një ndër shkaqet kryesore të punës së fëmijëve, nëse marrim në konsideratë varfërinë,

ndonëse ajo ka ardhur duke ulur, për shkak të rritjes së prodhimit të përgjithshëm bruto, ajo nuk është eliminuar në tërësi dhe vazhdon të përbëjë një problem shqetësues për shumë familje.

Ekzistojnë arsye të shumta se pse fëmijët punojnë, mire si arsye e fuqishme që pranohet nga të gjithë është puna për të siguruar të ardhura apo kafshatën e gojës për familjen.

Shkaqet ekonomike

- Sipas vlerësimit të bankës botërore grupi i popullësisë që jeton në varfëri ekstreme e ka të pamundur që të plotësojë edhe nevojat më bazë për ushqim⁵. Kjo varfëri tmerrësisht ndikon në vullnetin e fëmijës për punë. Kjo varfëri lidhet me vendin ku jeton fëmija, por dhe me familjen e tij. Rrethanat mund të kërkojnë që fëmijët të kontribuojnë në ekonominë e familjes, kur ajo përballlet me sigurimin e mbijetesës dhe mundësi të kufizuara punësim të të rriturve.

Problemet e veçanta me të cilat përballen këto familje mund t'i detyrojnë fëmijët të kërkojnë dhe të kryejnë punë që nuk janë në fushën e traditës së tyre, në mënyrë që të sigurojnë mbijetesën e familjes. “Më pëlqen të shkoj në shkollë, por më duhet të lajë xhamat e makinave, sepse përndryshe mami nuk ka se çfarë të na japë për të ngrënë” thotë E.L. Fëmijët e familjeve të divorcuara; fëmijët që jetojnë në jetimore dhe fëmijët e prindërve me aftësi të kufizuara mund të jenë nën një presion të jashtëzakonshëm për tu punësuar.

- Papunësia: Ndryshimi i sistemit nëvendet e Evropës Lindore dhe Juglindore mbylli mjaft aktivitete ekonomike dhe rriti numrin e të papunëve, të moshës së aftë për punë. Sipas INSTAT treguesit e papunësisë në shkallë vendi për vitin 2020 janë 17.3 % ndërsa për vitin 2021 rreth 17.1 %.

Ndonëse në dukje paradoksale, papunësia e të rriturve ekziston përkrah me punësimin e fëmijëve dhe sipas bindjes sonë përbën një nga faktorët nxitës të punësimin të fëmijëve. Tregu i punës ofron mundësi të ndryshme për të rriturit krahasuar me fëmijët. Papunësia kontribuon në krijimin e varfërisë dhe ajo përbën një dukuri shqetësuese, që ka shoqëruar

⁵ Jusufi, G., Bellaqa, B., “Trade Barriers and Exports between Western Balkan Countries,” *Naše Gospodarstvo/Our Economy*, Vol.65, No.4, (December, 2019), pp.74. Qasur në: <http://www.ng-epf.si/index.php/ngoe/article/view/219>

shoqërinë shqiptare gjatë viteve të tranzicionit. Papunësia është e lidhur ngushtë me mundësitë që ofron tregu i punës si dhe me mundësitë e kufizuara që ka familja për të siguruar ushqim, veshje, strehim dhe nevoja të tjera bazë materiale dhe shpirtërore për anëtarët e saj.

- Tregu i punës: Tregu i punës ofron vende pune në katër sektorë kryesorë si në tregti, shërbime, transport dhe ndërtim. Pjesa më e madhe e punëdhënësve janë biznesmenë të vegjël ose të mesëm. Një pjesë e punëdhënësve nuk kanë liçence për ushtrim aktiviteti dhe kanë një sërë problemesh që lidhen me detyrimet ndaj shtetit.

Nga vlerësimi rezulton se janë katër arsye kryesore të punësimit të fëmijëve nga punëdhënësit:

- Dëshira e punëdhënësve për t'i ndihmuar ekonomikisht fëmijët dhe familjet e tyre,
- Marrja e një zanati,
- Interesi ekonomik,
- Lidhja e miqësisë.

Puna e fëmijëve është më e lehtë për ta menaxhuar, pasi fëmijët janë më pak të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, krijojnë më pak shqetësime, ankohen më pak, janë më fleksibël dhe paguhen më pak, për shkak të moshës së tyre.

- Mungesa e Infrastrukturës: Dukë qenë se vendet e Ballkanit Perendimor apo të Evropës Juglindore janë shtete të varfëra, ato kanë mungesa të dukshme të infrastrukturës. Në zonat rurale mungojnë rrugët e përshtatshme për të shkuar në shkollë ose shkollat gjenden në kushte të vështira. Mungesa e infrastrukturës së duhur shkollore dhe kushteve të përshtatshme i shtyn fëmijët drejt largimit nga shkolla. Sipas Bankes Botërore, varfëria monetare bëhët më e theksuar si rezultat i infrastrukturës dhe shërbimeve të dobëta apo i mungesës së tyre në të gjithë vendin, në veçanti në Shqipëri e Kosovë. Rreth 40% e familjeve nuk sigurojnë dy ose më shumë shërbime bazë si: arsimimin 9- vjeçar, furnizimin me ujë dhe ngrohjen⁶.

⁶ Children's Human Rights Centre– CRCA, PUNA E FEMIJEVE DHE FEMIJET E RRUGES - Një studim mbi shfrytëzimin ekonomik dhe punën e detyruar të fëmijëve. Qasur në:

1.7 Strategjia e Republikës së Kosovës për eliminimin e punës së fëmijëve

Institucionet kosovare janë të përkushtuar të zvogëlojnë dhe ta eliminojnë punën e fëmijëve. Strategjia dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës bazohen në dokumente të rëndësishme të Republikës së Kosovës dhe në politikat e strategjitë ekzistuese, ku përfshihen:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Strategjia dhe Plani i veprimeve që duhet ndërmarrë për të drejtat e njeriut në Kosovë për periudhën 2009- 2019;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë;
- Plani i Veprimit për Partneritetin Evropian;
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve.

Parimet themelore mbi të cilat është bazuar procesi i hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit janë:

- ❖ Të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të Planit të Veprimit do të kenë në qendër të vëmendjes së tyre respektimin e të drejtave të fëmijëve.
- ❖ Moskeqësimi i gjendjes së fëmijëve si rezultat i ndërhyrjeve të ndryshme të natyrave të ndryshme.
- ❖ Të gjitha format e këqija të punës së fëmijëve janë të patolerueshme, pavarësisht gjendjes së vështirë ekonomike në të cilën ndodhet fëmija apo familja e tij.
- ❖ Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe me dokumentet e tjera të miratuara në Kosovë, fëmijët nën moshën 15 vjeç dhe ata në 15-18 vjeç nuk duhet të punojnë por duhet të shkollohen.
- ❖ Ndërhyrja për parandalimin dhe eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve do të ndjek tre synime strategjike: parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në format më të këqija të punës së fëmijëve; tërheqjen dhe rehabilitimin e fëmijëve të përfshirë në format

më të këqija të punës; si dhe mbrojtjen e të gjithë fëmijëve që janë mbi moshën minimale për punësim nga shfrytëzimi dhe format e rrezikshme të punës.

- ❖ Institucionet përgjegjëse duhet të kenë të njëjtin angazhim, si dhe të krijojnë mekanizma koordinimi mes tyre që të mundësojnë politika dhe veprime multi-sektoriale dhe të integruara. Një theks i veçantë do t'i kushtohet barazisë gjinore në të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren në kuadër të këtij plani veprimi. Puna e fshehtë e vajzave do të jetë objekt i veçantë për hulumtim dhe përgjigje.
- ❖ Fëmijët dhe familjet e tyre janë konsultuar si pjesë e procesit të hartimit dhe do të konsultohen po ashtu me rastin e vlerësimit të intervenimeve të drejtpërdrejta që do të zbatohen gjatë fazës së parë të planit të veprimit.

1.8 Dimensionet institucionale për parandalimin e punës së fëmijëve

Akerët institucional që duhet zbatuar politika e strategji për reduktimin e punës së fëmijëve mund t'i përmledhim në disa pika:

- **Institucionet qeveritare:**
- **Koordinimi në nivel qendror:**
- **Njësia për Punën e Fëmijëve:** Ekzistenca e një pike koordinuese në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale është thelbësore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia dhe Plan i Veprimit. NJPF do të shërbejë si sekretariat për të gjitha aktivitetet, si dhe për KKPEPF, duke organizuar dhe raportuar për të gjitha takimet dhe aktivitetet.
- **Sindikatat dhe punëdhënësit:** Përfaqësimi i tyre në GTP siguron që pikëpamjet e tyre janë përfshirë në Strategji dhe Plan Veprimi dhe përbëjnë bazën për angazhimin e tyre të mëtijshëm në zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të parashikuara.
Përmes Këshillit Ekonomik Social janë krijuar parakushtet për forcimin e mëtijshëm të dialogut social në Kosovë, si dhe të integritetit të shqetësimeve që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve në politikat dhe planet zhvillimore të Kosovës. Sindikatat dhe punëdhënësit në

Kosovë do të jenë një nga elementët e rëndësishëm të monitorimit të punës së fëmijëve dhe të pilotimit të Kodeve të Etikës për punëdhënësit, rritjes së ndërgjegjësimit, si dhe ndërhyrjeve të tjera në përputhje me rastet individuale të përfshirjes së fëmijëve në FKPF.

- **Shoqëria civile:** Grupet e interesuara në komunitet, OJQ dhe shoqëria civile në përgjithësi gjithashtu kanë qenë pjesë e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Vetë fëmijët, si edhe familjarë të tyre, si edhe shoqata të bazuara në komunitet janë një mekanizëm efektiv për monitorimin e bazuar në komunitet, si edhe forcimin e formave efektive që parandalojnë përfshirjen e fëmijëve në FKPF.
- **ILO:** Iu ndihmon palëve të interesuara në luftimin e punës së fëmijëve. Pra përmes fondeve, teknikave e projekteve të ndryshme lufton punën e fëmijëve.
- **Kontributi i programeve dhe projekteve tjera që luftojnë punën e fëmijëve:** Janë projekte të ndryshme që kontribojnë në sensibilizimin e fëmijëve për të mos punuar në moshë të re.

Përpjekjet për përfshirjen e punës së fëmijëve në agjendën vendore për të drejtat e fëmijëve dhe zhdukjen e varfërisë dhe programeve universale për edukim të organizatave tjera ndërkombëtare, do të shërbejë edhe në përpjekjet për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, që mbështeten nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, por edhe partnerë të tjerë. Po ashtu edhe programet e BE-së janë të rëndësishme dhe duhet të shfrytëzohen për edukimin dhe emancipimin e fëmijëve kosovar⁷. Disa nga projektet dhe programet e partnerëve të tjerë të cilat mund të plotësojnë intervenimet e parapara me planin e punës përfshijnë:

Instrumentet e para anëtarësimit Programi IPA (Instrumentet e Para Anëtarësimit), i mbështetur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZDKE) për periudhën 2009-2012, përmban këta komponentë:

- ✓ Komponenti 1: Kualifikimi i mësuesve dhe drejtorëve, synon trajnimin e mësuesve, për të përmirësuar dhe fuqizuar cilësinë e arsimit, nëpërmjet krijimit të një sistemi të qëndrueshëm për trajnimin e mësuesve si dhe trajnimin e drejtorëve të shkollave për të

⁷ Jusufi, G., Ajdarpašić, S., "The Impact of EU Programmes on Financing Higher Education Institutions in Western Balkans – Evidence from Kosovo," *LEXONOMICA Journal of Law and Economics*, Vol.12, No.1, (June, 2020), pp.125. Qasur në: <https://journals.um.si/index.php/lexonomica/article/view/530>

përmirësuar kapacitetet menaxheriale në nivel shkolle dhe vendi. Partner për zbatim: MASHT.

- ✓ Komponenti 2: Përfshinë asistencën teknike për të kapërcyer këto peripeci.
- ✓ Komponenti 3: Kosova e bukur, synon krijimin e vendeve të punës, që në të njëjtën kohë do të promovojnë regjenerimin urban, ambientin, sipërfaqet e gjelbra, hapësirat për rekreacion dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore.

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit: Arritja e objektivave të mijëvjeçarit (OZHM) dhe avansimi i përfshirjes sociale në bashkëpunim me shoqërinë civile, sektorin privat dhe bashkëpunëtorë tjerë të fushës së zhvillimit, mbështetur nga UNDP.

Promovimi i punësimit: Programi i UNDP-së për promovimin e punësimit dhe tregut të punës (2007-2011) në vazhdim të projektit për gjenerim të punësimit (2005-2007), që synon rritjen e aftësive për punë dhe të mundësive për punësim tek grupet më në nevojë.

Projekti kundër trafikimit: Projekti kundër trafikimit, zbatuar nga IOM23 dhe Akademia për Edukim dhe Zhvillim (AED) në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me shoqërinë civile me fokus tek të rinjtë.

UNICEF: UNICEF ka sponsorizuar disa studime mbi varfërinë tek fëmijët (të botuara) dhe një sondazh mbi opinionin e të rinjve. Gjatë vitit 2010 UNICEF do të mbështesë një studim gjithëpërfshirës mbi mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.

GTZ - Bashkëpunimi Teknik Gjerman: Në bashkëpunim me MASHT, ka iniciuar projektin “Zhvillimi i Kapaciteteve për Sektorin e Arsimit Fillor”. Përfituesit janë nxënësit e klasave 1 deri 9 si dhe fëmijët e të rinjtë, të cilët e kanë braktisur shkollën dhe që kërkojnë arsimim të mëtutjeshëm apo janë të detyruar të sigurojnë vetë jetesën.

Objektivi i katërt i këtij projekti është: Arsimi joformal dhe masat plotësuese për adresimin e braktisjes së hershme të shkollës. Në këtë kuadër, GTZ-ja ofron këshillim për fillimin dhe themelimin e strukturave joformale arsimore në nivel komunal. Projekti synon në zhvillimin e një sistemi arsimor joformal dhe të qëndrueshëm që ju ofron personave që braktisin shkollën një mundësi të dytë të arsimimit, që shpie ose në kthimin e tyre në sistemin formal ose ju ofron të rinjve shkakësi të nevojshme për sigurimin e jetesës së tyre.

DFID – Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Mbretërisë së Bashkuar: Në

bashkëpunim me MPMS si dhe MAPL, DFID do të realizojë një projekt me një kohëzgjatje prej 3 vjetësh, që përveç të tjerave, ka edhe këto rezultate të pritshme:

- ✓ Rritja e kapacitetit të qeverisë qendrore për të përkrahur dhe monitoruar ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, të decentralizuara
- ✓ Rritja e kapacitetit komunal për të menaxhuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, në përputhje me nevojat.
- ✓ Përkrahja e decentralizimit nga donatorët është harmonizuar nën udhëheqjen e MLGA dhe në përputhje me parimet evropiane⁸.

1.9 Konventat e ILO-s për fëmijët dhe të drejtat e tyre

ILO-ja ka miratuar 2 instrumente që të udhëheqin punën e saj në fushën e mbrojtjes së drejtave të fëmijëve: Konventa e Moshës Minimale (1973) (Nr.138), dhe Format më të Rënda të Punës Fëmijërore (1999) (Nr.182), të cilat hynë në fuqi në vitin 2000. Më 1992 u caktua që (iu dha detyrë) Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës Fëmijërore (International Programme on the Elimination of Child Labour – IPEC) – t’i plotësojë 18 standardet e ILO-s.

Konventa e Moshës Minimale (1973) (Nr.138) konsolidon dhe rishikon Konventën e mëparshme që mirrej me moshën minimale në sektorë të ndryshëm, siç janë: bujqësia, peshkataria, industria, detaria, punësimi jasht-industrial dhe puna nëntoksore. Elementet kryesore të saja janë:

- ✓ Qëllimi i Konventës (Të zhdukë punën fëmijërore),
- ✓ Mjetet e veprimit (Politika nacionale të zhdukë punën fëmijërore,
- ✓ Të rregullohet vazhdimisht mosha minimale e punës së fëmijëve.

⁸ Republika e Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË. Qasur në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PER PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNES SE FEMIJEVE NE KOSOVE 2011 - 2016.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_DHE_PLANI_I_VEPRIMIT_PER_PARANDALIMIN_DHE_ELIMINIMIN_E_PUNES_SE_FEMIJEVE_NE_KOSOVE_2011_-_2016.pdf)

Fusha të ndaluara të punës fëmijërore (nuk mund të bëhen përjashtime):

- ✓ Ndërtimtari,
- ✓ Puna me rrymë elektrike, gaz dhe ujëra,
- ✓ Prodhimtari;
- ✓ Miniera dhe gurishte;
- ✓ Plantazhe dhe ferma (me përjashtim të atyre që janë pronë familjare),
- ✓ Shërbime sanitare;
- ✓ Transport, rojtari dhe komunikacion.

Përjashtime nacionale (të bëra pas konsultimeve me organizatat punëtore dhe punëdhënëse):

- ✓ Shfaqje artistike,
- ✓ Punë të lehta që nuk i penalizojnë fëmijët në fazat e tyre të mësimit dhe edukimit,
- ✓ Kategori të kufizuara të punësimit e të punës ku mund të paraqiten probleme në aplikimin e Konventës,
- ✓ Stërvitje profesionale dhe të çirakut.

Raportim i Detyrueshëm nga tereni (nuk mund të përjashtohet):

- ✓ Punësim i cili nuk do ta rrezikonte aspektin mental dhe social të fëmijëve.
- ✓ Aktivitete të nevojshme nga qeveritë: Mosha minimale e përkufizuar për të punuar nuk guxon të jetë nën 14—15 vjeçare,
- ✓ Të definohen aktivitetet që nuk përjashtohen,
- ✓ Të definohet moshën minimale për fëmijë që të hyjnë në forcë punëtore.

Konventa mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve (1999) (Nr.182) ILO erdhi në përfundim se ekzistonte nevoja për një Konventë që do të fokusohet në format më të dëmshme të punës së fëmijëve. Në 1998 në kryeqendrën e ILO-s në Gjenevë arriti një marrsh global kundër punës së fëmijëve, duke e detyruar ILO-n që të miratojë masa të rrepta ndaj kësaj çështjeje. Në Qershor 1999, ILO-ja miratoi Konventën mbi Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve (Nr.182).

Konventa Nr.182 e plotëson Konventën Nr.138 dhe merr parasysh edhe klauzolat e instrumenteve relevante(dokumente)-siç janë Konventa mbi Punën e Detyrimshme (1930) dhe

Konventën Shtuese të KB mbi Zhdukjen e Skllavërisë, Tregëtisë dhe të Institucioneve dhe Praktikave të Ngjajshme me Skllavopronarinë (1956).

Konventa Nr.182 hyri në fuqi më 19 Nëntor 2000. Pra kjo është konventë e rëndësishme. Sipas të dhënave nga Janari i 2002, 113 shtete kanë ratifikuar Konventën Nr.182. Ajo dallohet përnga të qenurit Konventë e ILO-s me shkallë më të shpejtë të ratifikimit, që paraqet një tregues për mbarë botën për të ndaluar këtë praktikë (punën e fëmijëve).

Puna e fëmijëve i ka disa forma më të këqija të cilat janë:

- ✓ Shitja e fëmijëve nga trafikantët,
- ✓ Robërimi si borxh dhe bujkrobëria,
- ✓ Puna e detyruar (nën shtrëngim) ose e detyrimshme (nën forcë) duke përfshirë edhe rekrutimin e fëmijëve në konflikte të armatosura,
- ✓ Prostitucioni i fëmijëve ose pornografia,
- ✓ Aktivitete të ndaluara, posaçërisht shit-blerja dhe bartja e drogës,
- ✓ Puna që ka gjasa të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve (këto duhen të përcaktohen me anë të ligjeve dhe rregulloreve nacionale).

Mjetet:

- ✓ Programet akcionale për t'i larguar (hequr) fëmijët nga këto forma të punës;
- ✓ Kujdes ndaj fëmijëve që janë në pozitë të rrezikshme dhe vajzave;
- ✓ Ndihmë direkte për rehabilitimin dhe integrimin social të fëmijëve të zhvendosur;
- ✓ Programe edukative që përfshijnë mundësi për shkollim fillestar të papaguar dhe trajnim të mjeshtrive;
- ✓ Mekazma mbykëqirës.

Aksioni i nevojshëm nga qeveritë:

- ✓ Dizajnim i autoritetit kompetent (të qeverisë) që do të bënte zbatimin në jetë të Konvetës;
- ✓ Përforcimi i sanksioneve penale;

- ✓ Të formulojë listën e punëve që do të duhej të ndaloheshin (të rikalohen dhe rishqyrtohen për ndryshime sipas nevojës).

Elementet kryesore të Rekomandimit Nr.190 janë se qeveritë duhen:

- Të marrin në konsiderim vështrimet jo vetëm të organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve, por gjithashtu edhe të grupeve të tjera të përfshira, duke marrë në konsiderim ata të fëmijëve, të njerëzve të rinj dhe familjeve të tyre;
- Me shembuj të përcaktohen se cilat janë punët që i demoralizojnë dhe i dëmtojnë fëmijët.

Deklarata mbi Principet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë (1998): Më 1998, ILO miratoi një deklaratë që ta ripohojë zotimin e 175 shteteve anëtare të ILO-s se do t'i respektojnë principet themelore të ILO-s, të cilat janë esenciale për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të ILO-s. Deklarata e ILO-s mbi Principet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë i thërret të gjitha shtetet anëtare që t'a përkrahin dhe realizojnë aplikimin univerzal të të katër principeve të të drejtave fundamentale njerëzore, konkretisht:

- (i) eliminimi i aktiviteteve të punës së detyrueshme,
- (ii) Tregtia kolektive,
- (iii) zhdukja e punës së fëmijëve, dhe
- (iv) barazia në punësim dhe punë.

ILO ka paramenduar një strategji dy-krahëshe për të vlerësuar ndikimin e Deklaratës dhe për të tërhequr vëmendjen ndaj shkallës gjer të cilën shtetet anëtare janë duke i respektuar këto principe themelore:

- ✓ Rishqyrtim (Inspektim) Vjetor i vendeve lidhur me zbatimin e parimeve universal. Kjo i përcakton fushat ku shtetet anëtare ndeshen me probleme, dhe ku ILO-ja mund të ofrojë ndihmën e saj.
- ✓ Raport Global në njërin nga të katër principet e të drejtave fundamentale njerëzore.

Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD- / Organization for Economic Co-operation and Development) e përdori Deklaratën si një bazë për të rishikuar direktivat për ndërmarrjet multinacionale, duke treguar lidhshmërinë e rëndësishme ndërmjet standardeve themelore të punës dhe tregëtisë ndërkombëtare. Meqenëse nuk është legjisht e detyrueshme, Deklarata mban një influencë morale dhe bindëse pasi që shtetet-anëtare pritet që të tregojnë besnikëri ndaj principeve të saja.

Publikimi i Rishqyrtimit Vjetor dhe i Raportit Global janë poashtu elemente të rëndësishme në tërheqjen e vëmendjes kah të katër principet themelore dhe çështjet e lidhura me ta, dhe mund të jetë i dobishëm për organizatat e pakicave dhe të njerëzve vendës, si dhe për OJQ-të që mirren me ta⁹.

KAPITULLI 2

⁹ Organizata punëtore ndërkombëtare: Doracak për pakicat dhe njerëzit vendës, (2002). Qasur në: https://minorityrights.org/wp-content/uploads/2015/08/MRG_Train_ILO_ALB_2003.pdf

2. POLITIKAT SOCIALE NË KOSOVË

2.1 Punësimi dhe mirëqenia në Kosovë

Punësimi është një problematikë e madhe e cila e ka shoqëruar Kosovën gjithmonë në çdo system politik e ekonomik. Shkalla e punësimit nënkupton shkallën e të punësuarve në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullatës që kanë të drejtë të punojnë, kurse shkalla e papunësisë nënkupton shkallën e të papunëve në mesin e fuqisë punëtore (që është ekonomikisht aktive).

Kriteret për të përfituar një asistencë financiare që ka të bëjë me papunësinë, duhet të jenë të rrepta dhe të rregulluara mirë. Politikat aktive, në anën tjetër, kanë për qëllim aktivizimin e punësimit duke ruajtur vendet e punëve ekzistuese, dhe duke inkurajuar krijimin e vendeve të reja të punës ose përmes vetëpunësimit.

Kjo politikë zbatohet në disa forma:

Punësimi i subvencionuar – Përmes programeve publike punësohen njerëz të ndryshëm;

Marrëdhëniet kontraktuale - kur qeveria nënshkruan kontratë me punëdhënësin i cili ofron punë;

Programet e trajnimit - kur të punësuarve u ofrohen programe trajnimi për ngritjen e shkathtësive, etj.

Tregu i punës dhe punësimit në Kosovë karakterizohet me një shkallë të lartë të papunësisë (30.9%), me një shkallë të ulët të punësimit (25.5%), me një shkallë shumë të lartë të popullsisë që janë në moshë pune por që nuk janë ekonomikisht aktiv (63.1%), me një shkallë të lartë të papunësisë së të rinjve (55.3%), me një shkallë shumë të ulët të punësimit të femrave (10.7%), si dhe me papunësi afatgjate ku 90% e të papunëve të regjistruar janë të papunë afatgjatë (mbi 12 muaj).

Shkalla e lartë e papunësisë në vazhdimësi e ka përcjellë Kosovën që nga paslufta. Strategjisë së punësimit të qeverisë kosovare i mungojnë objektiva të qarta, gjë që vështirëson edhe vlerësimin e efektit të saj. Një dokument tjetër strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe plani për zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë dokument strategjik, i njohur si “Plani i Veprimtari i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2013”. Edhe me këtë dokument strategjik

problemi nuk qëndron vetëm tek shifrat ambicioze, por në atë se nuk është shumë specifik dhe nuk tregon saktësisht se si do të bëhet rritja ekonomike dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Institucionet shtetërore që ofrojnë të dhëna lidhur me punësimin, punëzënien dhe temat tjera janë:

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS),

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës që me anë të raportit vjetor tregon shifrat e kontribuuesve aktiv dhe kontribuuesve/të punësuarve të rinj. Problemi me të dhënat që ofrohen nga këto institucione, sidomos të dhënat e MPMS dhe ASK-së, është se dallojnë shumë nga njëra tjetra.

Megjithatë, te dy këto institucione, MPMS dhe ASK, në të dhënat që ofrojnë për vitin 2012 kanë një gjë të përbashkët: uljen e nivelit të papunësisë dhe punëkërkuesve të regjistruar, gjë që, siç do të shohim më vonë, është më shumë rezultat i ndërrimit të metodologjisë së llogaritjeve se sa i krijimit të hovshëm të vendeve të punës¹⁰.

2.2 Tregu i punës në Kosovë

Gjersa rritja e GDP-së në Kosovë ka mbetur pozitive përgjatë disa viteve të fundit, ajo vazhdon të shtyhet kryesisht nga remitancat, investimet publike dhe asistenca e donatorëve dhe përderisa kjo ka shërbyer për ta ruajtur atë nga kriza financiare e vitit 2008.

Spektori privat është i dominuar nga mikro-ndërmarrjet dhe sektoret që nuk kanë potencial për rritje. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme pozitive të GDP-së, mesatarisht 3.3% në vit që nga viti 2009, rritja ekonomike kryesisht është shtyrë nga konsumi nga remitancat (shumë pak prej të cilave janë përdorur për investime), si dhe nivelet e larta të shpenzimeve dhe investimeve të

¹⁰ Instituti GAP, Vlerësimi i Strategjisë së Punësimit: Nevoja për një strategji konkrete. Qasur në: https://www.institutigap.org/documents/16233_Vleresimi%20i%20Strategjise%20se%20Punesimit_Analize%20Politikash.pdf

sektorit publik (kryesisht për rrugë). Pjesa më e madhe e Investimeve të Huaja Direkte kanë qenë me fokus në sektorin e ndërtimit (investimet e diasporës në pasuri të patundshme).

Si rezultat, sektori i brendshëm privat në Kosovë vazhdon të jetë i nënzhvilluar dhe i dominuar nga mikro-ndërmarrjet e sofistikuara që janë ose në pronësi familjare ose kompani ('individuale') të cilat më së shumti tregtojnë mallra të importuara (raporti i importit dhe eksportit të Kosovës është 9 me 1).

Eksportet janë të kufizuara dhe deficitit tregtar mbetet i madh. Përderisa eksportet u rritën me 10% nga viti 2013 në 2014, importet më 2014, në vlerë prej rreth 2.5 miliardë euro, tejkalonin nivelin e eksporteve në masë të madhe (325 milion euro). Kurse periudha e pandemisë ndikoi edhe më shumë në nivelin e eksporteve.

Gjatë pesë viteve të fundit, janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të identifikuar, analizuar dhe priorizuar investimet në sektorët që kanë potencial të rritjes edhe për eksport edhe për krijimin e vendeve të punës, përpunimin e metaleve, tekstilit dhe lëkurës, përpunimit të drurit dhe turizmit, por megjithatë, ende mbetin sfida të konsiderueshme, duke përfshirë: procedurat doganore, mundësitë e kufizuara për të vendosur lidhje me rrjetet e biznesit ndërkombëtar, marrëdhëniet politike me vendet eksportuese, mungesa e financimit dhe kredive për eksporte, kostoja e lartë e garancive bankare dhe standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Kosova ka popullatën më të re në Evropë. Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç përbëjnë 19.4% të popullatës totale dhe gati një të tretën e popullatës së moshës së punës (28%). Përderisa gratë kanë filluar t'i kalojnë burrat në shkollimin universitar, gratë e reja ende janë më me gjasë ta braktisin shkollimin bazë, sidomos ato në zonat rurale.

Statistikat e arsimit të ASK-së tregojnë se gratë janë të nën-përfaqësuar. Të dhënat nga Anketa Klaster me Tregues të Shumëfishtë (MICS) tregojnë se përderisa nuk ka dallime në vijimin e shkollimit fillor në mes të djemve dhe vajzave, Indeksi i Barazisë Gjinore (IBGJ) tregon se vajzat janë më të diskriminuara në këtë aspekt.

Pasiviteti i lartë dhe migrimi ulin presionin e ofertës së lartë të fuqisë punëtore. E gjithë kjo kontribuon në ulje të ofertës së punës e cila gjithashtu ka qenë historikisht e reduktuar nga migrimi. Shumë raporte po ashtu konstatojnë se kosovarët në përgjithësi emigrojnë në moshë të

re. Mosha mesatare në kohën e migrimit për meshkujt është 25 vjeç, ndërsa për femrat është 22 vjeç.

Përdorimi i ulët i portaleve të punës në internet vjen si pasojë jo vetëm e mungesës së cilësisë, por edhe kërkesës së ulët të fuqisë së punës dhe mbështetjes tek departamentet e Burimeve Njerëzore (BNJ) nga ana e ndërmarrjeve më të mëdha.

Literatura tregon se përdorimi i madh i rrjeteve sociale (familje, miq, të afërm, etj.) është kryesisht i nxitur nga perceptimet mbi faktorët kryesorë në arritjen e punësimit. Duke pasur parasysh kushtet e tregut të punës në Kosovë dhe se 81% të kosovarëve besojnë që lidhjet familjare, ryshfeti, anëtarësia partiake dhe faktorë të tjerë jomeritorë janë mënyrat më të mira për të arritur punësim në institucione publike, nuk është çudi që ky mbetet burimi kryesor përmes të cilit të rinjtë kërkojnë punë¹¹.

2.3 Të rinjtë dhe problemet e tyre në Republikën e Kosovës

Veprimtaria rinore në Kosovë bazën ligjore e ka te Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë Nr. 03/L-145. Për më tepër, ky ligj, detajizon edhe disa prej fushave ku pjesëmarrja e të rinjve është e obligueshme si në:

- arsim;
- punësim;
- shëndet publik;

¹¹ UNDP, Mirëqenia dhe problemet sociale në Kosovë. Qasur në: www.undp.org

- çështje sociale;
- kulturë, sport dhe rekreacion;
- edukim qytetar dhe demokraci;
- ambient, planifikim hapësinor dhe zhvillim rural.

OJQ-të nga fusha e aktiviteteve rinore janë partnerët më të rëndësishëm në këtë aspekt. Në përgjithësi, 88 OJQ-të rinore përbëhen prej rreth 450 anëtarëve; 61% prej tyre janë meshkuj dhe 39% janë femra. Ata zakonisht janë profesionistë të kualifikuar me diplomë universiteti (59%) ose kanë të përfunduar shkollimin e mesëm (39%).

Gjithashtu ekziston një rrjet i qendrave të rinisë të shpërndara nëpër komuna të ndryshme. Qëllimi i qendrave rinore, është të sigurojnë një hapësirë për të rinjtë që ata të takohen dhe të shoqërohen, të ofrojnë aktivitete kulturore dhe sportive, mbështetje profesionale dhe të nivelit të njëjtë për çështje shëndetësore dhe psiko-sociale, si dhe trajnime relevante. Gjatë hulumtimit janë regjistruar 19 qendra të rinisë në 17 komuna (51% e komunave).

Këto qendra të rinisë tani veprojnë si OJQ. Procesi i hapjes së qendrave rinore në të gjitha komunat do vazhdon, me përkrahjen e DiR, DKRS dhe donatorëve ndërkombëtar. Në hulumtimet e kryera rezultojnë se Këshillat e Veprimit Rinor Lokal (KVRL) janë të konsoliduara, të cilat konsiderohen të jenë pjesë e shoqërisë civile.

2.4 Edukimi joformal i të rinjve dhe adoleshentëve

Nga rezultatet e hulumtimeve të ndryshme, me grup-moshat 15-24 vjeç, të cilin e ka realizuar sektori për edukim jo-formal në kuadër të Departamentit të Rinisë të Qeverisë së Kosovës, mbi njohuritë për edukimin jo formal, rezultojnë se nga 100 të rinj të anketuar, 68 % e tyre nuk janë të informuar mbi edukimin jo-formal dhe rëndësinë e tij në ndërtimin e karrierës.

Andaj, duke bërë promovimin dhe nxitjen e të rinjve për vijueshmërinë në edukimin jo-formal dhe në të njëjtën kohë duke informuar të gjitha palët e interesit mbi rëndësinë e njohjes së edukimit jo-formal, do të krijohen kushtet për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve, njohjen dhe vlerësimin e edukimit jo-formal.

Një ndër elementet e rëndësishme që ndikon pozitivisht në edukimin jo-formal është edhe përfshirja e të rinjve në projekte inovative dhe creative. Praktika në punë është një masë e tregut të punës që synon të ofrojë mundësinë e fitimit të përvojës së vlefshme në mjedisin e punës për pjesëmarrësit që kërkojnë të hulumtojnë apo fitojnë njohuri përkatëse dhe shkathtësi të kërkuara për të hyrë në fushën e caktuar të karrierës.

Mosnjohja e tregut të punës; mungesa e informacioneve për zhvillimin e rrethanave të tregut si ofertës dhe kërkesës në tregun e punës; edukimi jo i mirë në ndërmarrësi; mosnjohja e bazës ligjore për t'u marrë me ndërmarrësi; mungesa e zhvillimit ideor për të ndërmarrë iniciativa për themelimin e biznesit; mungesa e besimit në vete dhe ambientit të ndërmarrësisë nëse mund të kenë sukses; mungesa e njohurive mbi kreditë dhe lehtësimet që ofrojnë bankat për biznese janë disa nga faktorët që konsiderohen si problematik.

Nga kjo pikëpamje është veçanërisht e rëndësishme të ofrohet mbështetje për bizneset e reja në ndërmarrësi, mentorim dhe udhëzime për ndërmarrësit e rinj, si dhe promovim dhe zhvillim i kulturës së ndërmarrësisë¹².

Rezultatet e Programit të Vlerësimit Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) tregojnë se nga 72 vende pjesëmarrëse, Kosova radhitet në grupin e tri vendeve me performancën më të ulët. Këto rezultate tregojnë performancën e nxënësve që i vijnë shkollat e mesme anekënd Kosovës.

Më 12 prill dhe më pas më 16 dhe 17 prill, nxënësit e moshës 12 vjeçare iu nënshtruan sërish testit në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë. Ata i testuan njohuritë e tyre në matematikë, shkencë dhe lexim. Kësaj here testi është zhvilluar përmes kompjuterëve dhe jo me dorë. Testi po ashtu u realizua edhe në Prizren dhe në komunat e tjera. Raundi i parë i testimit do të përfundojë më 26 prill kurse rezultatet e Programit të Vlerësimit Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) do të publikohen në dhjetor.

Për BE-në rezultatet e publikuara ishin shqetësuese prandaj BE-ja bëri thirrje për reforma dhe më shumë transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha nivelet. Para disa vitesh, një skandal shpërtheu pasi që në librat e biologjisë njerëzit me Sindromën Down përshkruheshin si “idiotia mongoloide” – një term përbuzës në këtë aspekt. BE-ja dhe donatorët i kanë këshilluar akterët e

¹² Qeveria e Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Strategjia Kosovare për Rininë. Qasur në: https://qaint.org/wp-content/uploads/2019/09/STRATEGJIA_KOSOVARE_PER_RININE.pdf

ndryshëm dhe palët e interesuara që ta ndërrojnë këtë praktikë dhe të përshtaten me njohuritë më të përditësuara dhe profesionale.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e Kosovës në vitin 2011 e kanë inicuar Kornizën e Kurrikulës për arsimin parauniversitar. Me të është prezantuar ndryshimi i ligjërimit nga ai me mësuesin në qendër tek ai me nxënësin në qendër, përmes metodave moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke u bazuar në rezultatet dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Qëllimi ishte që të përgatiteshin të rinjtë që të përballen me sfidat e shekullit të 21-të, për të gjeneruar njohuri të reja konkurruese për tregun global të punës dhe për të rregulluar sistemin arsimor parauniversitar. Ky ndërrim nga kurrikula e përqendruar në përmbajtje tek ajo e bazuar në kompetencë është thelbësore për arritje më të mira të nxënësve.

Përveç shtatë fushave të nxënies - gjuhët dhe komunikimi, matematika, shkencat, shoqëria dhe mjedisi, shëndeti dhe mirëqenia, jeta dhe mjedisi, shkathtësitë kyçe përfshijnë edhe komunikimin dhe shprehjen, të menduarit, të mësuarit, të jetuarit, të punës dhe shkathtësive të tjera personale dhe qytetare.

Këto reforma kërkojnë më shumë materiale mësimore, trajnime për mësimdhënësit dhe vlerësime të reja. Aktualisht, vetëm rreth 10% e shkollave në Kosovë janë duke e zbatuar kurrikulën e re dhe vetëm 30% e mësimdhënësve janë të trajnuar për këtë. Zbatimi i ngadalshëm është për shkak të numrit të vogël të trajnerëve dhe kualifikimeve të tyre të pamjaftueshme për të trajnuar. Integrimi i Teknologjisë Informative dhe të komunikimit (TIK) në mësimnxënie dhe mësimdhënie është i pashmangshëm për të ardhmen e nxënësve nëse shkollat duan ta ruajnë vëmendjen e nxënësve.

Aktualisht ekzistojnë 39 institucione të arsimit të lartë të akredituara, nëntë prej të cilave janë publike dhe 30 private. Numri i studentëve është shtuar nga 40.000 në vitin 2004 në 119.000 në vitin 2017/2018. Rritja e shpejtë e numrit të studentëve të regjistruar ka kontribuar edhe në nevojën për të hapur universitete të reja publike. Përveç Universitetit të Prishtinës janë edhe pesë universitete publike në Prizren, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Ferizaj.

Kosova shpenzonte 703 euro për kokë banori (ose 23,8% të GDP-së për kokë banori) në Arsimin e Lartë. Kurse sot shpenzon rreth 845 Euro. Ndonëse shpenzimi publik është duke u shtuar, shpenzimi për student është duke rënë për shkak të numrit të shtuar të studentëve.

Objektivat e Planeve Arsimore Strategjike të Kosovës e vënë theksin në përmirësimin e cilësisë përmes promovimit të përsosmërisë në mësimdhënie, hulumtime shkencore, inovacion dhe ndërkombëtarizim. Mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve po ashtu është një prej objektivave. BE-ja e ka ndihmuar arsimin e lartë përmes projekteve të ndryshme.

Njëri prej tyre ishte përparimi i arsimit në Kosovë: projekti i ndërkulturalizmit dhe Procesit i Bolonjës në vlerë prej 1,4 milionë eurosh. Projekti e përfshinte mbështetjen për reformat në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë për të përmirësuar vetëdijen dhe mirëkuptimin ndërkulturor dhe për të integruar më tutje Kosovën në Procesin e Bolonjës. Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së sistemit të arsimit në përgjithësi është bërë përmes qasjes që mbulon gjithë sektorin në projektin e arsimit me vlerë 3 milion euro. Ky projekt, po ashtu ka çuar te ndërtimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për arsimin së bashku me MASHT-in¹³.

2.5 Puna e fëmijëve dhe situata socio-ekonomike në Kosovë

Republika e Kosovës ballafaqohet me një ekonomi të rëndë. Të gjithë indikatorët makroekonomikë dhe social e vendosin Kosovën në mesin e vendeve më të varfra në Evropë. Papunësia në Kosovë ndonëse ka shënuar një ngritje të madhe pas vitit 1990 kur punëtorët shqiptar u dëbuan nga vendet e tyre të punës prej ndërmarrjeve të atëhershme industriale.

Në vitin 2006, vetëm 5 nga çdo 100 të rinj kanë kaluar një tranzicion të suksesshëm nga shkolla në punësim, dhe prej këtu në punësim të qëndrueshëm.² Rritja ekonomike pas një ngritjeje gati në nivel dyshifror menjëherë pas luftës së viteve 1998-99, përsëri ka shënuar rënie.

¹³ EU Information and Cultural Centre, Arsimi Cilësor në Kosovë (2021). Qasur në: https://europehouse-kosovo.com/wp-content/uploads/2018/06/EDUCATION_publication_alb2.pdf

Sipas FMN-së vitin e kaluar rritja ekonomike ishte në 4.0% ndërsa për vitin 2010 parashihet rritje prej 4.3%. Gjithashtu bruto prodhimi vendor për kokë banori vitin e kaluar ishte 1,730 Euro ndërsa për këtë vit parashihet të jetë 1,800 Euro. Sa për të ilustruar se kjo rritje ekonomike është e pamjaftueshme duhet theksuar se për t'i zënë të ardhurat e Shqipërisë, Kosova duhet të përjetojë 10 % rritje të GDP-së për ta zënë nivelin e Shqipërisë gjatë 10 viteve të ardhshme.

Në anën tjetër për të arritur GDP-në për kokë banori të Malit të Zi, e cila është 5,700 Euro, Kosovës i duhet të ketë rritje ekonomike vjetore prej 12% në dhjetë vitet e ardhshme. Rritja e tanishme ekonomike nuk garanton edhe përmirësimin e situatës në sektorin e punësimit. Ekonomia është kryesisht e bazuar në shërbime hoteliere, bujqësi, tregti dhe ndërtime. Prodhimi është ende simbolik, me një industri ushqimore që është në fillesat e saj dhe me një bujqësi e blegtori të cilat përpëliten në fazat e para të zhvillimit të tyre. Përderisa në vitet 80' dhe 90' bujqësia zinte 25% të GDP-së, tash ajo zë vetëm 12%.

Industria zë vetëm 11% të GDP-së, dhe ajo ende vuan nga diversifikimi i vogël i saj. Eksporti i Kosovës e ka pësuar një goditje jo të vogël kur pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina duke mos njohur vultat e shtetit të Kosovës i kanë ndaluar të gjitha eksportet e Kosovës për në ato shtete. Prandaj prodhuesit e Republikës së Kosovës kanë përfituar shumë pak nga këto marrëveshje.

Në këtë situatë Kosova vazhdon të mbulojë deficitin e madh tregtarë nga dërgesat e emigrantëve (remitancat), që sillen rreth 13-15% të GDP, Investimet e Jashtme Direkte (që janë aktivizuar më shumë në fazën e procesit të privatizimit dhe priten të rriten prapë me privatizimin dhe dhënien me koncesion nga ana e qeverisë e disa prej aseteve kryesore si PTK, Aeroporti, sektori energjetik etj.) si dhe nga ndihmat dhe donacionet e jashtme

Qeveria e Kosovës duhet të bëhet më e kujdesshme, por njëkohësisht më aktive në dizajnimin e politikave ekonomike dhe fiskale që do ndihmonin në krijimin e kushteve për rritjen e investimeve private të brendshme dhe të jashtme, por edhe në përkrahjen e atyre ekzistueseve, sidomos atyre që janë të orientuar në prodhim.

Në këtë funksion duken të logjikshme rekomandimet e Bankës Botërore se zhvillimi i Kosovës do të duhej të fokusohet përmes orientimit të politikave shtetërore në tri fusha kryesore:

- ✓ Energji dhe miniera
- ✓ Kapital human
- ✓ Bujqësi

Kjo situatë realisht do të duhej ta orientonte qeverinë e Kosovës drejt zhvillimit dhe diversifikimit të tregut të punës, drejt politikave më të favorshme bujqësore si dhe drejt orientimit në zhvillimin e industrisë bazuar në pasuritë tokësore që ka Kosova si dhe në zhvillimin e potencialeve energjetike në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Një politikë e tillë domosdo do të krijonte kushte më të favorshme për zhvillim ekonomik, për zvogëlimin e papunësisë që do të duhej të ndikonte në zvogëlim e varfërisë.

2.6 Kategoritë sociale të cilat ndihmohen përmes skemave sociale të qeverisë së Kosovës

Përkrahja sociale në Kosovë është e orientuar kryesisht drejt ndihmës monetare mujore për familjet e varfra, po ashtu edhe për personat që janë me aftësi të kufizuara dhe që kanë humbur gjymtyrë në luftën e fundit çlirimtare të viteve 1998-1999.

Përkrahja për kategoritë sociale në Kosovë realizohet përmes këtyre skemave sociale:

- Skema e Asistencës Sociale (nga viti 2000) dhe skema e Nevojave të Veçanta (nga viti 2003);
- Skema e Invalidëve të Luftës dhe të Afërmve të tyre (nga viti 2001);
- Skema Pensionit Themelor (nga viti 2002) dhe Kontribut-dhënës (nga viti 2008);
- Skema e Pensioneve për Aftësi të Kufizuar (nga viti 2004);
- Skema e Pensioneve të Trepçës (nga viti 2003);

- Skema e Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar (që nga viti 2009).

Numri i përfituesëve është rreth 330,000. Politikat sociale të favorshme duhet të kombinohen mirë me politikat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Situatën e vështirëson tej mase edhe mungesa e një sistemi shëndetësor që do të funksiononte duke u mbështetur edhe në sigurimet shëndetësore. Mungesa e sigurimeve shëndetësore edhe në këtë rast më së shumti i godet kategoritë e varfra, pensionistët dhe shtresat me nevoja të veçanta.

Letra e Bardhë mbi Politikat Sociale, ende nuk është miratuar nga Qeveria e Kosovës, duke e lënë ata sipas fjalëve të Komisionit Evropian në raportin e fundit të progresit “pa prioritetet strategjike në këtë fushë”. Ndikimin kryesor në këtë drejtim e kanë pensionet bazë. Me tërheqjen e tyre do të rritej varfëria për 4.4, përkatësisht 4.6%. Në anën tjetër efektet e ndihmës sociale janë më modeste. Po të eliminoheshin ato rritja e varfërisë do të ishte 1.4% ndërsa ajo e varfërisë ekstreme 1.7%.

2.7 Programi i ndihmës sociale të Kosovës

Ky program, ka filluar të zbatohet që nga fillimi i vitit 2001. Kjo ndihmë financiare sillet rreth 40-80 Euro dhe varet nga madhësia e familjes. Një ndër të metat e zbatimit të kësaj politike, qëndron në faktin se është parashikuar që ndihmat sociale të indeksohen me inflacionin, gjë që nuk ka ndodhur prej kohës konvertimit të DM në Euro.

Duhet theksuar se sipas analizave të bëra në draftin e Letrës së Bardhë mbi Politikat Sociale në Kosovë, indeksimi duhet të bëhet për nivelin e inflacionit të shportës së ushqimeve (të përcaktuar nga Banka Botërore në vitin 2000) gjatë periudhës 2005-2008 për 27.35%. Në këtë rast niveli i ndihmës do të sillej prej 45-96 Euro në varësi të madhësisë së familjes.

Pavarësisht kësaj ndihme ende shumë familje nuk kanë dalur nga stadi i varfërisë ekstreme. Vënia në jetë e këtij propozimi do t'i kushtonte buxhetit të Kosovës dikur rreth 5.6 milion euro.²⁰ Në këtë draft letër janë dhënë edhe dy propozime të tjera të cilat nëse do të miratoheshin do të ndihmonin shumë pjesëtarë të familjeve në nevojë të dalin nga varfëria skajshme. E para ka të bëjë që familjet që marrin ndihmën sociale e që kanë fëmijë në moshë shkollore (6-18 vjeç) të marrin një ndihmë shtesë prej 5 eurove për çdo fëmijë.

Kjo ndihmë përveç të tjerave do të duhej të jepej me kushtin që fëmija të vijoje shkollimin dhe shihet si një masë për parandalimin e fenomenit të braktisjes së shkollës, që është i shpeshtë tek fëmijët e këtyre familjeve (20% e fëmijëve që braktisin shkollimin i takojnë këtyre familjeve). I dyti propozim ka të bëjë me rritjen e përkrahjes financiare për familjet që kanë më shumë se 7 anëtarë, prej 5 eurove për çdo anëtarë më shumë.

Së bashku me propozimin për indeksimin me inflacion të këtyre ndihmave, këto propozime buxhetit të Kosovës do t'i kushtonin diku rreth 8 milion euro. Skema aktuale i kushton buxhetit të Kosovës 27.3 milion euro, ndërsa kjo e propozuara do t'i kushtonte 35.57 milion euro.

Deri tani sipas analizës së bërë nga ekspertët e Komisionit Evropian dhe Bankës Botërore ky program ka qenë një mjet efektiv për transferimin e burimeve tek të varfrit. Kështu rreth 45% të benificioneve shkojnë në kuartalin më të varfër të popullsisë dhe vetëm 6% u shkojnë atyre në kuartalin më të pasur. Sipas analizës së cekur më herët, ky program është më i suksesshëm në krahasim me skemat në Serbi, Shqipëri dhe Bosnjë e Hercegovinë. Sidoqoftë vetëm 23% e të varfërve dhe 34% e të varfërve në varfëri të skajshme po arrijnë të mbulohen nga ky program. Duhet theksuar se edhe sasia monetare e ndihmës sociale është e pamjaftueshme për të nxjerrë përfituesit nga varfëria (mbi vijën e varfërisë së skajshme).

2.8 Strategjia e punësimit e Republikës së Kosovës në lidhje me punën e fëmijëve

Realizimi i projekteve të kësaj strategjie që kanë pas të bëjnë me punët publike janë realizuar me efikasitet.

Shtyllat kryesore të këtij dokumenti janë:

- ❖ Klima e investimeve pra përmirësimi i saj si dhe ulja e kostove të biznesit me qëllim të rritjes së shpejtësisë së krijimit të vendeve të punës përmes inkurajimit të hapjes së firmave të reja dhe zgjerimin në aktivitete me më shumë vlerë të shtuar.
- ❖ Promovimi i një baze të fuqishme të shkathtësive dhe zhvillimi më të madh të kapitalit njerëzor përmes arsimit formal dhe sistemeve të trajnimit profesional.

- ❖ Përmirësimi i funksionimit të tregut të punës përmes institucioneve më të mira të tregut të punës, politikave dhe procedurave.

Në planin afatshkurtër, strategjia kërkon rritjen dhe zgjerimin e investimeve publike (si p.sh. projektet e mëdha infrastrukturore) dhe programeve të punëve publike (të cilat kryesisht fokusohen në projekte komunale), në mënyrë që për një kohë më të shkurtër të intervenohet në zbutjen e papunësisë. Përmes këtyre masave afatshkurtra synohet edhe krijimi i vendeve të mjaftueshme të punës për të mbuluar rritjen neto në fuqinë punëtore (për të mos u rritur përqindja e të papunëve, rreth 15,000 vende të reja pune duhet të krijohen në vit nga ekonomia).

Në planin afatmesëm, kjo strategji synon të sigurojë një rrugë të qëndrueshme ekonomike përmes reformave ekonomike. Zhvillimi i këtyre sektorëve planifikohet të krijojë vende të reja pune dhe atë vende më të qëndrueshme pune, të rrisë investimet private, përfshirë investimet e huaja direkte (IHD), dhe të krijojë eksporte. Fokusimi do të bëhet në këto pika:

- infrastrukturën biznesore, që mendohet të bëhet përmes reformimit të sektorit të energjisë, rritjes së investimeve publike në infrastrukturë si dhe themelimit të zonës industriale në Drenas etj.
- lehtësimin e kufizimeve financiare,
- kornizën rregullative, duke lehtësuar procedurat e lincimit të bizneseve, lejeve të punës si dhe duke rivlerësuar edhe kornizën e inspektimeve.
- informatat e dobëta të tregut dhe bazën e dobët të shkathtësive për bizneset e vogla, duke krijuar kushte për ofrimin e shërbimeve cilësore të këshillimit për bizneset e reja dhe bizneset e vogla dhe të mesme, për t'i pajisur ato me shkathtësitë e nevojshme teknike dhe menaxheriale për t'iu ndihmuar që ato të nisin bizneset e tyre ose t'i rrisin ato ekzistueset.
- Përkrahja e institucioneve ekonomike.

Politikat që kanë të bëjnë me arsimin, shkathtësitë dhe trajnimin do të fokusohen në:

- arsimin profesional, reforma në arsimin dhe trajnimin profesional do të përqendrohet në krijimin e shkollave profesionale të quajtura Qendrat e Kompetencës, përf forcimi i lidhjes në mes të shkollës dhe tregut të punës si dhe shpërndarja e mëtutjeshme e përgjegjësi në shkolla.

- sistemin e trajnimit profesional, masat kryesore në këtë fushë do të jenë përmirësimi i qasjes në arsimin për të rritur si dhe krijimi dhe implementimi i kornizës së përgjithshme të kualifikimeve (në këtë kuadër duhet të themelohet Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve).

- arsimin e lartë, masat kryesore do të jenë rritja e cilësisë në arsimin e lartë dhe ndërlidhshmëria e tij më e madhe me tregun e punës dhe ekonominë në përgjithësi.

Politikat që kanë të bëjnë me institucionet e punës, politikat dhe rregulloret do të fokusohen në:

- do të bëhet modernizimi i shërbimeve të punësimit publik,

- mbështetja e migrimit të fuqisë punëtore,

- programet e tregut aktiv të punës,

- mbrojtja e punësimit, si pjesë e këtij synimi në proces të trajtimit parlamentar është ligji i ri i punës i cili do të mbulojë më shumë fusha nga mbrojtja në punë si dhe do të krijojë më shumë mundësi për implementimin e tij¹⁴.

2.9 Shërbimi publik i punësimit në Kosovë

Shërbimi Publik i Punësimit (ShPP) në Kosovë u themelua në vitin 2001 si pjesë e Ministrisë Së Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS) dhe përbëhet nga 7 qendra regjionale të SPP, 2 Zyra Komunale të Punësimit (ZP), dhe 8 Qendra të Trajnimit Profesional (QTP). Pas rishikimit të rezultateve të ShPP të bërë nga UNDP, një “koncept i integruar i shërbimit të punësimit”.

Sistemi i ri i Menaxhimit të Informatave (SMI) e mundëson dallimin mes punëkërkuesve aktiv dhe pasiv, dhe gjithashtu riorganizoi funksionin e këshilldhënësve, duke lejuar personin e papunë

¹⁴ Qendra për Hulumtime në të Drejta të Njeriut dhe Integritet Evropiane, SKEMAT SOCIALE DHE PËRSHTATSHMËRIA E TYRE ME REALITETIN KOSOVAR. Qasur në: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/09743.pdf>

të ndërveprojë me një menaxher të vetëm të rastit për këshillim, trajnim dhe punësim. Reformat e SHPP po vazhdojnë, dhe numri ë qështjeve të pazgjidhura mbetet.

Reformat e kohëve të fundit përfshijnë miratimin e planeve individuale, si dhe qasjet e ndryshme ndaj klientëve, dhe personel këshilldhënës të trajnuar më mirë. Megjithatë, një sfidë ka të bëjë me faktin se trajnimi i këshilldhënësve u kry nga donatorët në tërësi, duke ngritur pyetjet rreth qëndrueshmërisë afatgjate.

Një meta-vlerësim i kohëve të fundit i efikasitetit të politikave të tregut të punës (EPTT) tregon se ndikimet mesatare të EPTT janë pothuajse zero në afat të shkurtër por bëhen positive pas 2-3 viteve. Gjithashtu, ata gjejnë se:

- (i) ndikimet janë më të mëdha për femrat dhe të papunësuarit afatgjatë;
- (ii) përfitimet janë më të mëdha për programet që përqendrohen në akumulimin e kapitalit njerëzor (trajnim); dhe
- (iii) EPPT janë më efektive gjatë recesionit në një treg pune depresiv.

Kombinimi i papunësisë së lartë dhe afatgjate, veçanërisht mes femrave, dhe një treg depresiv i punës, mund të sygjerojnë një shkallë më të madhe të efikasitetit të EPTT, dhe vlerësimet e kohëve të fundit për disa programe trajnimi në vend të punës kanë treguar efekte pozitive në punësueshmëri.

Programi Aktiv i Tregut të Punës për Rini i UNDP në Kosovë kishte objektiv:

- (i) Forcimin e kapacitetit të institucioneve të tregut të punës në ofrimin e shërbimeve për klientë dhe për të bërë të vazhdueshme masat aktive të tregut të punës;
- (ii) Ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë në regjistrimin e punëkërkuesve përmes trajnimit-në-vend-pune (TVP), trajnimit para-punësimit, subvencioneve të punësimit, dhe skemave të praktikës duke bërë partneritet me ndërmarrjet të cilat kërkojnë fuqi punëtore shtesë.

Faktorët që kontribuan në sukses përfshijnë:

- (i) zhvillimin e planeve individuale të punësimit për përfituesit,

- (ii) parazgjedhja e kujdesshme e ndërmarrjeve,
- (iii) përputhja e mirë e kandidatëve me profesionin apo lëminë e trajnimit, dhe
- (iv) cilësia e trajnimit¹⁵.

KAPITULLI 3

3. PJESA EMPIRIKE

¹⁵ WORLD BANK GROUP, DIAGNOZA E VENDEVE TË PUNËS: KOSOVË . Qasur në:
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/519991508764269649/pdf/ACS21442-WP-ALBANIAN-93p-KOSOVO-Jobs-Diagnostic-Final-for-printing-ALB.pdf>

3.1 Aspekti empirik i punës së fëmijëve

Kosova është ekonomia më e varfër dhe më e re në regjionin e Ballkanit Perendimor¹⁶. Statistikat në vijim pasqyrojnë më së miri gjendjen sociale e ekonomike të shtetit të Kosovës:

- 16% e kosovarëve jetojnë në nivelin e varfërisë së skajshme, kurse 45% e kosovarëve jetojnë nën kufirin e varfërisë;
- Mbo 50 % është shkalla e papunësisë në Republikën e Kosovës, kurse nën moshën 25 vjeqare është 50 % e papunësisë;
- Fëmijët dhe familjet e tyre janë shumë të prekur nga varfëria ekstreme. Pra varfëria ekstreme rrezikon këtë kategori.

Programi ndërkombëtar i ILO-s në Kosovë i ka disa synime. Aktivitetet kryesore të saj janë përqëndruar:

- Përfshirja e temës së punës së fëmijëve në legjislacionin dhe politikat përkatëse të republikës,
- Krijimin e kapaciteteve të institucioneve publike, ndërmarrjeve të punëdhënësve dhe të punëtorëve,
- Zhvillimin dhe testimin e Sistemit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve (SMPF),
- Ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët e përfshirë në FKPF apo që janë në rrezik për t'u përfshirë në FKPF dhe ngritjen e vetëdijes.

Duke ditur se partnerët social janë lojtarë të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për eliminimin e punës së fëmijëve, aktivitetet e IPEC-ut nga viti 2009 e tutje janë përqendruar në fuqizimin e përfshirjes së tyre në veprime dhe reagime kundër punës së fëmijëve¹⁷.

¹⁶ Jusufi, G., Ukaj, M., "Migration and Economic Development in Western Balkan Countries: Evidence from Kosovo," *Poslovna izvrsnost-Business Excellence*, Vol. 14, No.1, (June, 2020), pp.142. Qasur në: https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=347272

¹⁷ Organizata Ndërkombëtare e Punës, Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit?, (2010). Qasur në: http://www.oit.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_168750.pdf

3.2 Mostra e hulumtimit

Në këtë punim të nivelit master, mostra e hulumtimit përbëhet nga 20 fëmijë të anketuar, të cilët punojnë punë në sektorë të ndryshëm ekonomik. Këta fëmijë janë anketuar nga autorja e punimit dhe të gjithë janë fëmijë që kanë pasur kontakt me Organizata të ndryshme joqeveritare (OJQ), pra këto organizata kanë punuar me këta fëmijë në vetëdijësimin e tyre lidhur me konceptin e punësimit në moshë të re. Këto organizata janë munduar që t'i bindin këta fëmijë që të mos punojnë por të shkollohen ose të gjejnë ndonjë alternativë tjetër në vend të punës në moshë të re. Pra, përmes evidencave empirike do të mundohem të elaboroj ndikimin e OJQ-ve në punën e fëmijëve. Evidencat empirike do të pasqyrojnë faktin se sa këto OJQ ndikojnë në vetëdijësimin e fëmijëve në punën e tyre në moshë të re.

Tabela 2: Statistikat deskriptive

	N		Mean	Std. Error of Mean	Median	Mode	Std. Deviation	Variance
	Valid	Missing						
Mosha_e_juaj	20	0	2.8000	.24709	3.0000	4.00	1.10501	1.221
Origjina_e_juaj	20	0	1.5500	.19835	1.0000	1.00	.88704	.787
Në_cilin_sektor_punoni	20	0	2.9500	.21120	3.0000	3.00	.94451	.892

Arsyeja_qe_punoni	20	0	1.6500	.19568	1.0000	1.00	.87509	.766
A_jeni_duke_u_shkolluar	20	0	1.9000	.06882	2.0000	2.00	.30779	.095
A_punoni_me_deshire_apo_jeni_te_detyr	20	0	1.1500	.08192	1.0000	1.00	.36635	.134
Cila_OJQ_ka_punuar_me_juve	20	0	2.1500	.31014	2.0000	1.00	1.38697	1.924
Si_e_vleresoni_angazhimin_e_OJQ	20	0	4.1500	.26433	5.0000	5.00	1.18210	1.397
Sa_ka_ndikuar_kjo_OJQ_ne_jeten_tuaj	20	0	3.8500	.29267	4.0000	5.00	1.30888	1.713
A_e_keni_nderprere_punen_si_rezultat_i_OJQ	20	0	1.8000	.09177	2.0000	2.00	.41039	.168

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Tabela e mësipërme paraqet statistikën deskriptive. Statistikat descriptive mundën me u grupu në disa grupe të cilat janë: përqindjet, mesataret, moda, varianca dhe korelacionet. Moda është vlera që më së shumti është e shprehur në shpërndarjen e frekuencave. Mediana matë tendencën qendrore. Pra ka rëndësi të madhe. Mediana është i ndanë vlerat nga më e ulta në më të lartën. Mediana këto vlera i ndanë në 2 gjysma të barabarta.

Mesatarja gjendet gjatë pjestimit të numrit total të vrojtimeve me vlerat e variablës së caktuar. Mesatarja është e thjeshtë dhe e ponderuar. Varianca është mesatarja e deviacioneve në katror të çdo vlerë ndajmesatares, në një varg vlerash të vazhduara. Që do të thotë se varianca e një variabli Y, është deviacioni mesatar kuadratik. Varianca është gjithmonë një numër jo-negativ për shkak të ngritjes në katror¹⁸.

3.3 Paraqitja dhe interpretimi i rezultateve statistikore

Në këtë njësi do të paraqiten rezultatet e hulumtimit statistikor veç e veç për secilën pyetje të pyetësorit. Secili rezultat e pyetjes së parashtruar është paraqitur përmes tabelave dhe histogrameve. Histogramet janë forma më e përhapur dhe më e thjeshtë e paraqitjes së një frekuence. Pyetja e parë ka të bëjë me moshën e respondentëve apo fëmijëve të anketuar. Kjo

¹⁸ UNDP&INSTAT, Njohuri Statistikore, (2005). Qasur në: <http://www.instat.gov.al/media/6056/4-njohuri-statistikore.pdf>

pyetje i ka 4 kategori. Siç mund të shihet më së shumti fëmijë ka me moshën 16-17 vjeqare, konkretisht 7 fëmijë i takojnë kësaj moshe, apo 35% e fëmijëve.


Tabela 3: Mosha e fëmijëve të anketuar

Mosha_e_juaj				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
10-11 vjeq	3	15.0	15.0	15.0
12-13 vjeq	5	25.0	25.0	40.0
Valid 14-15 vjeq	5	25.0	25.0	65.0
16-17 vjeq	7	35.0	35.0	100.0
Total	20	100.0	100.0	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Më poshtë është paraqitur histogrami i moshës së fëmijëve të anketuar.

Figura 1: Histogrami i moshës së respondentëve



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me origjinën e fëmijëve apo respondentëve që punojnë. Siç mund të shihet 65% e respondentëve janë nga Kosova, ndërsa pjesa tjetër janë nga Shqipëria, refugjatë nga Siria si dhe të tjerë që nuk kanë dashur ta deklarojnë origjinën e tyre.


Tabela 4: Origjina e respondentëve
Origjina_e_juaj

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Kosove	13	65.0	65.0	65.0
	Shqiperi	4	20.0	20.0	85.0
	Siri	2	10.0	10.0	95.0
	Te tjera	1	5.0	5.0	100.0
	Total	20	100.0	100.0	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Figura e mëposhtme paraqet histogramin e përgjigjeve të këtyre respondentëve.

Figura 2: Histogrami i origjinës së respondentëve



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Pyetja në vijim paraqet veprimtaritë ku kryejnë punën e tyre këta fëmijë. Siç mund të shihet nga evidencat empirike, numri më i madh i fëmijëve punojnë në sektorin e shërbimeve, konkretisht si

kamariere në kafiteri dhe restorante të ndryshme. Mirëpo një numër jo i vogël i fëmijëve punojnë edhe si lypës. Ky është një indikacion jo i mirë sepse kjo tregon që ata mund të keqpërdoren për qëllime të errëta nga qarqe të ndryshme kriminale.


Tabela 5: Sektori i punës së fëmijëve të anketuar

Në cilin sektor punoni				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Ndertimtari	2	10.0	10.0	10.0
Tregti	3	15.0	15.0	25.0
Valid Sherbime	9	45.0	45.0	70.0
Lypes	6	30.0	30.0	100.0
Total	20	100.0	100.0	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Të dhënat e fituara statistikore janë paraqitur edhe me anë të histogramit të mëposhtëm.

Figura 3: Histogrami i veprimtarisë së fëmijëve punonjës



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Janë shumë të rëndësishme arsyet që këta fëmijë punojnë sepse nëse kuptohen arsyet e vërteta, më lehtë do të jetë të ndihmohen këta fëmijë nga OJQ-të në procesin e rehabilitimit të tyre social e psikologjik. Kushtet e vështira ekonomike i kanë detyruar këta fëmijë të punojnë në këtë moshë të re dhe delikate. Po ashtu edhe varfëria ekstreme dhe mungesa e prindit kanë ndikuar që këta fëmijë të orientohen në shumë veprimtari punuese. Duhet theksuar që varfëria ekstreme mund të ndikoj aq negativisht te këta fëmijë sa që këta të bien pre edhe të grupeve kriminale, të cilat mund t'i shfrytëzojnë këta fëmijë në realizimin e qëllimeve të tyre djallëzore.

Tabela 6: Arsyet e punës së këtyre fëmijëve


Arsyeja_qe_punoni

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
	Kushtet_e_veshtira_ekonomike	12	60.0	60.0	60.0
Valid	Jam kryefamiljar	3	15.0	15.0	75.0
	Varferia ekstreme	5	25.0	25.0	100.0
	Total	20	100.0	100.0	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Më poshtë është paraqitur edhe histogrami me të dhënat e kësaj pyetjeje.

Figura 4: Arsyet e punës së fëmijëve të anketuar



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Fëmijët janë pyetur se a janë duke u shkolluar gjatë kësaj periudhe. Shumica dërmuese e tyre janë deklaruar se nuk janë duke u shkolluar. Kjo tregon që puna që e bëjnë nuk iu jep mundësi këtyre fëmijëve jo vetëm të shkollohen por as të shijojnë fëmijërinë e tyre. Shteti i Kosovës duhet urgjentisht të punojë me këta fëmijë në mënyrë që most ë kenë një fëmijëri të përbuzur. Aq sa institucionet shtetërore Kosovare, edhe OJQ-të që merren me fëmijë duhet të punojnë edhe më shumë me fëmijët e tillë për t'iu siguruar një të ardhme më të mirë.


Tabela 7: Vazhdimi i shkollimit të fëmijëve punonjës

A_jeni_duke_u_shkolluar				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2	10.0	10.0	10.0
Valid Jo	18	90.0	90.0	100.0
Total	20	100.0	100.0	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Më poshtë është paraqitur edhe histogrami i të dhënave të fituara statistikore

Figura 5: Vazhdimi i shkollimit të fëmijëve punonjës



Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Fëmijët punonjës janë pyetur se a punojnë me vetëdëshirë po e kundërta janë të detyruar të punojnë nga familja apo grupet e caktuara. 17 prej fëmijëve janë deklaruar se punojnë me vetëdëshirë kurse 3 prej tyre janë deklaruar se punojnë pa vetëdëshirë pra janë detyruar nga familja apo grupet e caktuara të punojnë.


Tabela 8: Burimi i punës së fëmijëve

A_punoni_me_deshire_apo_jeni_te_detyr

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	17	85.0	85.0	85.0
	Jo	3	15.0	15.0	100.0
	Total	20	100.0	100.0	

Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Figura 6: Burimi i punës së fëmijëve



Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Nga fëmijët e anketuar është kërkuar të deklarohen se cila prej OJQ-ve ka punuar me ata, thjeshtë cila nga ata ka treguar ndjeshmëri ndaj gjendjes së tyre fizike e emocionale. Shumica e fëmijëve janë deklaruar se SAVE THE CHILDREN është OJQ-ja që ka punuar më së shumti me ata. Po ashtu edhe OJQ-të tjera kanë punuar me këta fëmijë me qëllim të zvogëlimit të punës dhe aktivitetit tyre punues.


Tabela 9: OJQ-të që kanë punuar për të zvogëluar punën e këtyre fëmijëve

Cila_OJQ_ka_punuar_me_juve

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Save the children	9	45.0	45.0	45.0
CARITAS	5	25.0	25.0	70.0
GIZZ	2	10.0	10.0	80.0
Valid Kosovo Education Center-KEC	2	10.0	10.0	90.0
Balkan Sunflowers Kosova	2	10.0	10.0	100.0
Total	20	100.0	100.0	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Figura 7: OJQ-të që kanë punuar për të zvogëluar punën e këtyre fëmijëve



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS


Fëmijët janë pyetur se si e vlerësojnë angazhimin e këtyre OJQ-ve në zvogëlimin e punës së tyre. 55% e tyre janë deklaruar se e vlerësojnë shumë mire angazhimin e këtyre OJQ-ve. Prandaj mund të thuhet se këto OJQ kanë pasur angazhim të konsiderueshëm në uljen e punës së fëmijëve.

Tabela 10: Angazhimi i OJQ-ve në zvogëlimin e punës së fëmijëve

Si_e_vleresoni_angazhimin_e_OJQ				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	1	5.0	5.0
	Pak	1	5.0	10.0
	Neutral	3	15.0	25.0
	Mesatarisht	4	20.0	45.0
	Shume	11	55.0	100.0
	Total	20	100.0	100.0

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Figura 8: Angazhimi i OJQ-ve në zvogëlimin e punës së fëmijëve



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Nga fëmijët e anketuar është kërkuar që të deklarohen se sa ka pasur ndikim puna e këtyre OJQ-ve në jetën dhe veprimtarinë e tyre. 40% e tyre janë deklaruar se puna me këto OJQ ka pasur shumë ndikim të madh, 30% janë deklaruar se këto OJQ kanë pasur ndikim mesatarisht te jeta


dhe veprimtaria e tyre punuese, kurse pjesa tjetër janë deklarur që janë neutral, pak dhe aspak nuk ka pasur ndikim veprimtaria e këtyre OJQ-ve të jeta e tyre.

Tabela 11: Ndikimi i OJQ-ve në jetën dhe veprimtarinë e këtyre fëmijëve

Sa_ka_ndikuar_kjo_OJQ_ne_jeten_tuaj				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	2	10.0	10.0
	Pak	1	5.0	15.0
	Neutral	3	15.0	30.0
	Mesatarisht	6	30.0	60.0
	Shume	8	40.0	100.0
	Total	20	100.0	100.0

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Figura 9: Ndikimi i OJQ-ve në jetën dhe veprimtarinë e këtyre fëmijëve



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Në pyetjen e fundit, është synuar të mirret informacion nga fëmijët e anketuar, se këto OJQ a kanë ndikuar vërtetë në ndërprerjen e punës së këtyre fëmijëve. Fatkeqësisht vetëm 4 prej fëmijëve të anketuar janë deklaruar se e kanë ndërprerë punën e tyre pas angazhimit të këtyre


OJQ-ve, kurse një pjesë e madhe janë deklaruar se nuk e kanë ndërprerë punën e tyre pas aktiviteteve me këto OJQ.

Tabela 12: Ndëprerja e punës së fëmijëve pas punës me këto OJQ

A_e_keni_nderprere_punen_si_rezultat_i_OJQ				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	4	20.0	20.0	20.0
Valid Jo	16	80.0	80.0	100.0
Total	20	100.0	100.0	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Figura 10: Ndëprerja e punës së fëmijëve pas punës me këto OJQ



Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

3.4 Vërtetimi i hipotezave

Hipoteza e parë e këtij punimi të nivelit master mund të definohet kështu:

H0: Organizatat joqeveritare (OJQ-të) ndikojnë pozitivisht në jetën e këtyre fëmijëve që punojnë në sektorë të ndryshëm;

H1: Organizatat joqeveritare (OJQ-të) nuk ndikojnë pozitivisht në jetën e këtyre fëmijëve që punojnë në sektorë të ndryshëm;

Për të shikuar se cila nga këto hipoteza qëndron e saktë, do të përdoret Testi Chi Square:

	Value	Asymp.Sig.(2-sided)
Pearson Ch-Square	7.415	0.620
Likelihood Ratio	9.023	0.591
Linear by linear Association	2.842	0.079
Number of valid cases	10	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Duke u bazuar në rezultatet e kësaj tabele, ku 0.62 është vlerë më e madhe se 0.05 hipoteza 0 pranohet si e saktë, kurse hipoteza 1 refuzohet. Pra mund të pohohet se organizatat joqeveritare (OJQ-të) ndikojnë pozitivisht në jetën e këtyre fëmijëve që punojnë në sektorë të ndryshëm.

Hipoteza e dytë e këtij punimi është paraqitur më poshtë:

H0: Angazhimi i OJQ-ve, ka ndikuar që këta fëmijë të ndërprejnë punën e tyre;

H1: Angazhimi i OJQ-ve, nuk ka ndikuar që këta fëmijë të ndërprejnë punën e tyre;

Për të shikuar se cila nga këto hipoteza qëndron e saktë, do të përdoret Testi Chi Square:

	Value	Asymp.Sig.(2-sided)
Pearson Ch-Square	2.045	0.046
Likelihood Ratio	2.562	0.627
Linear by linear Association	0.091	0.741
Number of valid cases	20	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Në këtë rast, mbasiqë vlera 0.045 është më e vogël se 0.05, hipoteza 0 refuzohet, kurse pranohet hipoteza 1. Ky rezultat tregon që pavarësisht se këto organizata janë angazhuar shumë në

edukimin, emancipimin dhe vetëdijësimin e fëmijëve për punën e tyre, ato nuk kanë mundur të ndikojnë në eliminimin e tërësishëm të punës së këtyre fëmijëve.

Hipoteza e tretë dhe e fundit e këtij punimi mund të formulohet si më poshtë:

H0: Sa më në moshë të jenë fëmijët e analizuar aq më e lartë do jetë mundësia e tyre për t'u kyqur në tregun e punës;

H1: Mosha e fëmijëve që punojnë nuk ndikon në aktivitetin e tyre punues.

Për të shikuar se cila nga këto hipoteza qëndron e saktë, do të përdoret Testi Chi Square:

	Value	Asymp.Sig.(2-sided)
Pearson Ch-Square	2.461	0. 721
Likelihood Ratio	2.081	0.602
Linear by linear Association	0.961	0.620
Number of valid cases	20	

Burimi: Të dhënat e autorit të përpunuara në SPSS

Mbasiqë vlera 0.721 është më e madhe se 0.05, hipoteza 0 pranohet si e saktë, ndërsa hipoteza 1 refuzohet si e pasaktë. Pra mosha e fëmijëve ndikon në qasjen e tyre në punë. Të dhënat tona tregojnë se me rritjen e moshës së fëmijëve rritet edhe numri i tyre që punojnë.

PËRFUNDIMI

Si fenomen jo i mirë, puna e fëmijëve ka qenë dhe është preokupim i shumë institucioneve të të gjitha vendeve të botës. Mirëpo si rezultat i kushteve ekonomike e sociale vendet e pazhvilluara nuk kanë arritur asesi ta stopojnë punën e fëmijëve. Madje në shumë vende të pazhvilluara si në Kosovë, Maqedoni Veriore, Shqipëri, Bosnie e Hercegovinë, etj, përveç që fëmijët fillojnë të punojnë në moshë shumë të re, ata keqpërdoren nga shumë grupe kriminale.

Këto grupe kriminale të cilat veprojnë si rrjet i sofistikuar i krimit, i trafikojnë, i detyrojnë të kërkojnë lëmshë fëmijët të cilët janë pa përkujdesje nga prindërit, jetojnë në kushte të vështira ekonomike, dhe i maltretojnë psikikisht e fizikisht duke u shkaktuar trauma shpirtërore e emocionale.

Përveç institucioneve qeveritare, rol të rëndësishëm në zvogëlimin e punës së fëmijëve kanë edhe Organizatat Joqeveritare (OJQ-të). Duke u bazuar në rezultatet e arritura empirike, nga elaborimi teorik dhe vërtetimi i hipotezave mund të ipen disa rekomandime lidhur me këtë problematikë të shqyrtuar:

- Organizatat joqeveritare (OJQ-të) ndikojnë pozitivisht në aktivitetet jetësore të fëmijëve të punësuar. Mbasigë u vërtetua nga aspekti statistikor ky pohim, OJQ-të që janë përgjegjëse në projekte të ndryshme për të drejtat e fëmijëve duhet të angazhohen me të madhe në vetëdijësimin e fëmijëve lidhur me punën që e bëjnë.

Duhet të ndahet më shumë buxhet për projekte e programe të ndryshme të cilat synim parësor e kanë zhvillimin dhe modernizimin e të drejtave të fëmijëve. Duhet të organizohen trajnime të karakterit psikologjik e social, etj...

- Evidencat empirike sugjerojnë që pavarësisht se këto OJQ kanë zhvilluar aktivitete me fëmijët punonjës, ato nuk kanë mundur të ndikojnë sa duhet në eliminimin e punës së tyre apo në zvogëlimin e punës së fëmijëve.

Prandaj si konkluzion mund të pohohet që këto OJQ duhet të kontaktojnë me familjet e këtyre fëmijëve, të përkrahen moralisht dhe materialisht këto familje të cilat jetojnë në varfëri ekstreme, në mënyrë që fëmijët e tyre të ndërpresin punën dhe angazhimin fizik. Kjo do të mundësonte që këta fëmijë të shijojnë fëmijërinë e tyre konform rregullave e konventave ndërkombëtare të fëmijëve.

- Këto evidence statistikore dhe empirike na dëshmojnë se OJQ-të duhet të angazhohen shumë më shumë për të bindur fëmijët që të mos punojnë port e orientohen në realizimin e synimeve fëmijërore nën përkujdesjen e prindërve të tyre.

LITERATURË E SHFRYTËZUAR

Fisnik Morina, Metodatat e Hulumtimit Kuantitativ. Universiteti “Haxhi Zeka”. Qasur në: <https://unhz.weebly.com/>

Avdulla Hoti, Metodologjia hulumtuese. Universiteti i Prishtinës. Qasur në: https://economics-pr.weebly.com/uploads/4/8/6/0/48608947/met_hulumtuese_l11_pergaditja_e_temes_master.pdf

International Labour Organization, Punëdhënësit dhe Puna e Fëmijëve. Qasur në: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_169136.pdf

Instituti SEDA & Save the children, Puna e fëmijëve, Tiranë, 2015. Qasur në: https://childhub.org/sq/system/tdf/library/attachments/child_labor_report_dec_2015.pdf?file=1&type=node&id=19344

Organizata Ndërkombëtare e Punës, HAPAT E ILO-IPEC PËR ELIMINIMIN E FORMAVE MË TË RËNDA TË PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË, (2011). Qasur në: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_168280.pdf

Jusufi, G., Bellaqa, B., “Trade Barriers and Exports between Western Balkan Countries,” *Naše Gospodarstvo/Our Economy*, Vol.65, No.4, (December, 2019), pp.74. Qasur në: <http://www.ng-epf.si/index.php/ngoe/article/view/219>

Children’s Human Rights Centre of Albania – CRCA, PUNA E FEMIJEVE DHE FEMIJET E RRUGES NE SHQIPERI- Një studim mbi shfrytëzimin ekonomik dhe punën e detyruar të

fëmijëve në Shqiperi. Qasur në:
<https://www.crca.al/sites/default/files/publications/PUNA%20E%20FEMIJEVE%20DHE%20FEMIJET%20E%20RRUGES%20NE%20SHQIPERI%202005.pdf>

Jusufo, G., Ajdarpašić, S., “The Impact of EU Programmes on Financing Higher Education Institutions in Western Balkans – Evidence from Kosovo,” *LEXONOMICA Journal of Law and Economics*, Vol.12, No.1, (June, 2020), pp.125. Qasur në:
<https://journals.um.si/index.php/lexonomica/article/view/530>

Republika e Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË 2011 – 2016. Qasur në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_DHE_PLANI_I_VEPRIMIT_PER_PARANDALIMIN_DHE_ELIMINIMIN_E_PUNES_SE_FEMIJEVE_NE_KOSOVE_2011_-_2016.pdf

Organizata punëtore ndërkombëtare: Doracak për pakicat dhe njerëzit vendës, (2002). Qasur në:
https://minorityrights.org/wp-content/uploads/2015/08/MRG_Train_ILO_ALB_2003.pdf

Jusufo, G., Ukaj, M., “Migration and Economic Development in Western Balkan Countries: Evidence from Kosovo,” *Poslovna izvrsnost-Business Excellence*, Vol. 14, No.1, (June, 2020), pp.142. Qasur në: https://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=347272

Organizata Ndërkombëtare e Punës, Si të parandalohen dhe eliminohen format më të këqija të punës së fëmijëve: Çfarë mund të bëjnë punëdhënësit?, (2010). Qasur në:
http://www.oit.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_168750.pdf

UNDP&INSTAT, Njohuri Statistikore, (2005). Qasur në:
<http://www.instat.gov.al/media/6056/4-njohuri-statistikore.pdf>

Instituti GAP, Vlerësimi i Strategjisë së Punësimit: Nevoja për një strategji konkrete. Qasur në:
https://www.institutigap.org/documents/16233_Vleresimi%20i%20Strategji%20se%20Punesimit_Analize%20Politikash.pdf

UNDP, Mirëqenia dhe problemet sociale në Kosovë. Qasur në: www.undp.org

Qeveria e Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Strategjia Kosovare për Rininë. Qasur në: https://qaint.org/wp-content/uploads/2019/09/STRATEGJIA_KOSOVARE_PER_RININE.pdf

EU Information and Cultural Centre, Arsimi Cilësor në Kosovë. Qasur në: https://europehouse-kosovo.com/wp-content/uploads/2018/06/EDUCATION_publication_alb2.pdf

Qendra për Hulumtime në të Drejta të Njeriut dhe Integritet Evropian, SKEMAT SOCIALE DHE PËRSHTATSHMËRIA E TYRE ME REALITETIN KOSOVAR . Qasur në:
<https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/09743.pdf>

WORLD BANK GROUP, DIAGNOZA E VENDEVE TË PUNËS: KOSOVË . Qasur në:
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/519991508764269649/pdf/ACS21442-WP-ALBANIAN-93p-KOSOVO-Jobs-Diagnostic-Final-for-printing-ALB.pdf>